



BOSCH

Register your
new device on
MyBosch now and
get free benefits:
[bosch-home.com/
welcome](https://bosch-home.com/welcome)



Makineri për larjen e enëve

SP...


[sq] Manuali i përdoruesit

Pasqyra e përmbytjes

| | |
|---|----------|
| Siguria | 4 |
| Udhëzime të përgjithshme | 4 |
| Përdorimi i parashikuar | 4 |
| Kufizimi i rrethit të përdoruesve | 4 |
| Instalimi i sigurt | 5 |
| Përdorimi i sigurt | 6 |
| Pajisja e dëmtuar..... | 8 |
| Rreziku për fëmijët | 9 |
| Sistemet e sigurisë | 10 |

| | |
|---|-----------|
| Shmangia e dëmeve materiale | 11 |
| Instalimi i sigurt | 11 |
| Përdorimi i sigurt | 11 |

| | |
|---|-----------|
| Siguresa për fëmijët¹ | 12 |
| Bllokimi i derës..... | 12 |

| | |
|--|-----------|
| Mbrojtja e mjedisit dhe kursimi | 13 |
| Hedhja e paketimit | 13 |
| Kursimi i energjisë..... | 13 |
| Tharja me zeolit  | 13 |
| Sensori i ujit ¹ | 14 |

| | |
|---|-----------|
| Instalimi dhe lidhja | 14 |
| Përmbytja e paketimit..... | 14 |
| Instalimi dhe lidhja e pajisjes | 14 |
| Lidhja e tubit shkarkues të ujit | 15 |
| Lidhja me rrjetin e ujit të pijshëm ... | 15 |
| Lidhja elektrike | 15 |

| | |
|------------------------------|-----------|
| Njohja | 16 |
| Pajisja | 16 |
| Elementet e përdorimit | 17 |

| | |
|--|-----------|
| Programet | 19 |
| Udhëzime për institutet e testimit... 21 | |

| | |
|-------------------------------|-----------|
| Funksionet shtesë..... | 21 |
|-------------------------------|-----------|

| | |
|------------------------------|-----------|
| Pajisja | 23 |
| Koshi i sipërm i enëve..... | 23 |
| Koshi i poshtëm i enëve..... | 24 |

| | |
|---|----|
| Koshi për takëmet e ngrënies..... | 25 |
| Sirtari i takëmeve të ngrënies | 25 |
| Rafti me palosje | 26 |
| Telat mbajtës me palosje | 26 |
| Mbajtësja e pjesëve të vogla | 27 |
| Ndarja e thikave | 27 |
| Koka spërkatëse për tavat e pjekjes | 27 |
| Lartësitë e koshit të enëve | 28 |

| | |
|--|-----------|
| Përpara përdorimit për herë të parë | 29 |
| Vënia në përdorim për herë të parë | 29 |

| | |
|--|-----------|
| Sistemi i zbutjes së ujit..... | 29 |
| Pamja e përgjithshme e cilësimeve të fortësisë së ujit | 29 |
| Vendosja e sistemit të zbutjes së ujit | 30 |
| Kripa e veçantë | 30 |
| Fikja e sistemit të zbutjes | 31 |
| Rigjenerimi i sistemit të zbutjes..... | 32 |

| | |
|---|-----------|
| Sistemi i shkëlqyesit të enëve..... | 32 |
| Shkëlqyesi i enëve | 32 |
| Vendosja e sasisë shtesë së shkëlqyesit..... | 33 |
| Fikja e sistemit të shkëlqyesit të enëve..... | 33 |

| | |
|------------------------------------|-----------|
| Detergjenti | 34 |
| Detergjenti i përshtatshëm | 34 |
| Detergjenti i papërshtatshëm | 35 |
| Udhëzime për detergjentet..... | 35 |
| Mbushja e detergjentit..... | 36 |

| | |
|--------------------------------------|-----------|
| Enët | 37 |
| Dëmtimet e gotave dhe të enëve... 37 | |
| Sistemimi i enëve | 38 |
| Zbrazja e enëve..... | 39 |

¹ Sipas pajimit të pajisjes

| | |
|---|-----------|
| Përdorimi bazë | 39 |
| Hapja e derës së pajisjes..... | 39 |
| Ndezja e pajisjes | 39 |
| Vendosja e programit..... | 40 |
| Vendosja e funksionit shtesë | 40 |
| Vendosja e zgjedhjes së kohës | 40 |
| Nisja e programit..... | 40 |
| Ndërprerja e programit..... | 40 |
| Ndërprerja e programit..... | 40 |
| Fikja e pajisjes..... | 41 |
| Regullimet bazë | 42 |
| Pamja e përgjithshme e cilësimeve bazë..... | 42 |
| Ndryshimi i cilësimeve bazë..... | 43 |
| Pastrimi dhe kujdesi | 44 |
| Pastrimi i kazanit të larjes | 44 |
| Hapësira e brendshme e vetë pastruesit ¹ | 44 |
| Produktet e pastrimit | 44 |
| Këshilla për kujdesin e pajisjes..... | 44 |
| Mirëmbajtja e enëlarëses  ¹ | 44 |
| Sistemi i filtrave sitë..... | 45 |
| Pastrimi i krahëve të spërkatjes | 46 |
| Mënjanimi i defekteve | 48 |
| Siguria e pajisjes | 48 |
| Kodi i gabimit / Treguesi i gabimit / Sinjali | 48 |
| Rezultati i shpëlarjes | 50 |
| Udhëzime në fushën e treguesit | 57 |
| Defektet e funksionit..... | 58 |
| Dëmtimi mekanik..... | 59 |
| Zhurma | 59 |
| Pastrimi i pompës së shkarkimit.... | 61 |
| Transporti, ruajtja dhe hedhja | 61 |
| Çmontimi i pajisjes | 61 |
| Mbrojtja e pajisjes nga ngrica..... | 62 |
| Transportimi i pajisjes | 62 |
| Hedhja e pajisjes së vjetër | 62 |

| | |
|---|-----------|
| Shërbimi i klientit | 62 |
| Numri i produktit (E-Nr.) dhe numri i prodhimit (FD)..... | 63 |
| Garancia AQUA-STOP ¹ | 63 |
| Të dhëna teknike | 63 |

¹ Sipas pajimit të pajisjes



Siguria

Respektoni informacionet për temën Siguria, që të përdorni pajisjen tuaj në mënyrë të sigurt.

Udhëzime të përgjithshme

- Lexoni me kujdes këtë manual. Vetëm atëherë mund ta përdorni pajisjen në mënyrë të sigurt dhe efikase.
- Ruani manualin dhe informacionet e produktit për përdorim të mëvonshëm ose për zotëruesin pasardhës të saj.
- Kontrolloni pajisjen pasi ta nxirrni nga paketimi. Mos e lidhni pajisjen nëse konstatoni dëmtime nga transporti.

Përdorimi i parashikuar

Për të përdorur pajisjen në mënyrë të sigurt dhe të saktë ndiqni udhëzimet për përdorimin e parashikuar.

Përdoreni pajisjen vetëm:

- në përputhje me këtë manual përdorimi.
- për të larë enët shtëpiake.
- për qëllime private familjare dhe në ambiente të mbyllura brenda shtëpisë.
- deri në një lartësi prej 2000 m mbi nivelin e detit.

Kufizimi i rrethit të përdoruesve

Evitoni rreziqet për fëmijët dhe personat e tjerë të rrezikuar.

Kjo pajisje mund të përdoret nga fëmijët e moshës 8 vjeç e lart dhe nga personat me aftësi të kufizuara fizike, ndijuese ose mendore apo me mungesë përvojë dhe/ose njohurish, nëse këta mbikëqyren ose udhëzohen për përdorimin e sigurt të pajisjes dhe ata i kuptojnë rreziqet që mund të lindin prej saj.

Mos lejoni fëmijët që të luajnë me pajisjen.

Pastrimi dhe mirëmbajtja nga përdoruesi nuk duhet të bëhen nga fëmijët pa mbikëqyrjen e një të rrituri.

Mbani fëmijët e moshës nën 8 vjeç larg pajisjes dhe kabllave të lidhjes elektrike.

Instalimi i sigurt

Mbani parasysh udhëzimet e sigurisë gjatë instalimit të pajisjes.

⚠ PARALAJMËRIM – Rrezik lëndimi!

Instalimet e papërshtatshme mund të shkaktojnë lëndime.

- ▶ Gjatë vendosjes dhe lidhjes së pajisjes ndiqni udhëzimet e manualit të përdorimit dhe të montimit.

⚠ PARALAJMËRIM – Rrezik nga goditja elektrike!

- Instalimet e gabuara janë shkak për rreziqe.
 - ▶ Lidhjeni pajisjen dhe vëreni në përdorim vetëm në rrjet elektrik sipas të dhënave në etiketën e parametrave.
 - ▶ Lidhjeni pajisjen vetëm nëpërmjet një prize të instaluar sipas rregullave me tokëzim, në një rrjet elektrik me rrymë alternative.
 - ▶ Sistemi mbrojtës i instalimit elektrik të shtëpisë duhet të jetë instaluar sipas rregullave.
 - ▶ Asnjëherë mos e ushqeni pajisjen përmes një aparature të jashtme vepruese, si p.sh. kohëmatës ose telekomandim.
 - ▶ Kur pajisja është e montuar inkaso, spina e kordoni elektrik duhet të jetë lehtësisht e arritshme ose kur aksesimi i saj nuk është i mundur, në instalimin e përcaktuar elektrik duhet të jetë instaluar një çelës ndarës shumëpolësh, sipas dispozitave të ndërtimit.
 - ▶ Gjatë instalimit të pajisjes bëni kujdes që kordoni elektrik të mos ngecet ose që të mos dëmtohet.
- Prerja e tubit të furnizimit ose zhytja e valvulës Aquastop në ujë është e rrezikshme.
 - ▶ Kurrë mos e zhytni trupin plastik në ujë. Trupi plastik në tubin e furnizimit ka një valvul elektrike.
 - ▶ Mos e pritni kurrë tubin e furnizimit. Në tubin e furnizimit gjenden telat e lidhjeve elektrike.

PARALAJMËRIM – Rrezik zjarri!

Kordoni elektrik i zgjatur dhe përshtatësi i palejuar janë të rrezikshëm.

- ▶ Mos përdorni kablo zgjatuese ose prizë bashkuese me shumë vende.
- ▶ Nëse kordoni elektrik është i shkurtër, kontaktoni me shërbimin e klientit.
- ▶ Përdorni vetëm përshtatësin e miratuar nga prodhuesi.

PARALAJMËRIM – Rrezik lëndimi!

Menteshat lëvizin gjatë hapjes dhe mbylljes së derës së pajisjes dhe mund të shkaktojnë lëndime.

- ▶ Nëse pajisjet nën banak ose pajisjet inkaso nuk qëndrojnë brenda një dollapi dhe në këtë mënyrë mund të arrihet faqja anësore, atëherë zona e menteshave duhet të vishet në anë. Mbulesat mund të gjenden në dyqanin e specializuar ose te shërbimi ynë i klientit.

PARALAJMËRIM – Rrezik animi!

Instalimi i papërshtatshëm mund të çojë në përmbysjen e pajisjes.

- ▶ Instaloni pajisjet nën banak ose pajisjet inkaso vetëm poshtë një sipërfaqeje pune të pandërprerë, e cila është e lidhur fort me dollapët ngjitur.

PARALAJMËRIM – Rrezik djegiesh!

Instalimi i papërshtatshëm i pajisjes mund të shkaktojë djegie.

- ▶ Te pajisjet që qëndrojnë të pavaruara mbani parasysh që pajisjet të mbështeten pas murit me anën e pasme.

Përdorimi i sigurt

PARALAJMËRIM – Rrezik dëmsh të rënda në shëndet!

Mosndjekja e udhëzimeve të sigurisë dhe të përdorimit në paketimet e produkteve të pastrimit dhe të shkëlqimit mund të shkaktojë dëmtime të rënda të shëndetit.

- ▶ Ndiqni udhëzimet e sigurisë dhe të përdorimit në paketimet e produkteve të pastrimit dhe të shpëlarjes.

⚠️ PARALAJMËRIM – Rrezik shpërthimi!

- Solucioni tretës në hapësirën e larjes së pajisjes mund të shkaktojë shpërthime.
 - ▶ Mos fusni kurrë solucion tretës brenda në hapësirën e larjes së pajisjes.
- Produktet e forta gërryese të pastrimit ose me përmbajtje të lartë acide mund të shkaktojnë shpërthime në kombinim me pjesët e aluminit në hapësirën e larjes së pajisjes.
 - ▶ Mos përdorni kurrë produkte pastrimi me përmbajtje të lartë alkaline-kaustike ose acidi, në veçanti nga ato të fushës profesionale apo të fushës industriale, p.sh. për mirëmbajtje enëlarëseje, në kombinim me pjesët prej alumini (p.sh. filtra yndyre nga aspiratorët apo tenxheret e aluminit).

⚠️ PARALAJMËRIM – Rrezik lëndimi!

- Dera e hapur e pajisjeve mund të shkaktojë lëndime.
 - ▶ Hapni derën e pajisjes vetëm për vendosjen dhe heqjen e enëve, për të parandaluar aksidente, p.sh. nga pengimi.
 - ▶ Mos u mbështesni ose mos u ulni mbi derën e hapur të pajisjes.
- Thikat dhe pajisjet me majë të mprehtë mund të shkaktojnë lëndime.
 - ▶ Futini thikat dhe pajisjet me majë të mprehtë, me anë të mprehta nga poshtë në koshin e takëmeve të ngrënies, në raftet e thikave ose në sirtarët e takëmeve të ngrënies.

⚠️ PARALAJMËRIM – Rrezik përvëlimi!

Jashtë pajisjes mund të shpërthejë ujë i nxehtë kur hapet dera e pajisjes gjatë kohës që programi është në punë.

- ▶ Hapni me kujdes derën e pajisjes gjatë kohës që programi është në punë.

⚠️ PARALAJMËRIM – Rrezik animi!

Shportat e mbingarkuara me enë mund të çojnë në animin e pajisjes.

- ▶ Kurrë mos i mbingarkoni shportat e enëve te pajisjet që qëndrojnë të pavarura.

⚠ PARALAJMËRIM – Rrezik nga goditja elektrike!

- Lagështia që futet brenda mund të shkaktojë goditje elektrike.
 - ▶ Përdoreni pajisjen vetëm në ambiente të mbyllura.
 - ▶ Asnjëherë mos e ekspozoni pajisjen në nxehtësi të madhe apo në lagështi.
 - ▶ Mos përdorni pastrues me avull ose pastrues me presion të lartë për të pastruar pajisjen.
- Izolimi i dëmtuar i kordonit elektrik përbën rrezik për jetën.
 - ▶ Mos lini kurrë që kordoni elektrik të bjerë në kontakt me pjesët e nxehta të pajisjes ose burime të tjera nxehtësie.
 - ▶ Mos lejoni kurrë që kordoni elektrik të bjerë në kontakt me maja ose me buzë të mprehta.
 - ▶ Mos e përdridhni, shtrëngoni apo ndryshoni kordonin elektrik.

⚠ PARALAJMËRIM – Rrezik djegiesh!

Vrima e shkarkimit të enës prej zeoliti nxehtet dhe mund të shkaktojë djegie.

- ▶ Mos e prekni kurrë portën e shkarkimit të enës me zeolit.

Pajisja e dëmtuar

Mbani parasysh udhëzimet e sigurisë nëse pajisja është e dëmtuar.

⚠ PARALAJMËRIM – Rrezik nga goditja elektrike!

- Pajisja e dëmtuar ose kordoni elektrik i dëmtuar përbëjnë rrezik për jetën.
 - ▶ Kurrë mos vini në punë një pajisje të dëmtuar.
 - ▶ Asnjëherë mos e vini në punë pajisjen me sipërfaqe të plasaritur ose të thyer.
 - ▶ Asnjëherë mos tërhiqni kordonin elektrik për të shkëputur pajisjen nga rrjeti elektrik. Hiqeni kordonin elektrik duke e kapur gjithmonë nga spina.
 - ▶ Kur pajisja ose kordoni elektrik është i dëmtuar, shkëputni menjëherë kordonin elektrik ose fikni siguresën në kutinë e siguresave dhe mbyllni rubinetin e ujit.
 - ▶ "Telefononi shërbimin e klientit." → *Faqe 62*

- ▶ Riparimet në pajisje duhen kryer vetëm nga staf teknik i trajnuar për këtë qëllim.
- Riparimet e gabuara janë shkak për rreziqe.
 - ▶ Riparimet në pajisje duhen kryer vetëm nga staf teknik i trajnuar për këtë qëllim.
 - ▶ Për riparimin e pajisjes lejohet të përdoren vetëm pjesë këmbimi origjinale.
 - ▶ Nëse dëmtohet kordoni elektrik i pajisjes, atëherë ai duhet të zëvendësohet me një kordon elektrik të veçantë, të cilin mund ta blini te prodhuesi ose te shërbimi i tij për klientin.

Rreziku për fëmijët

Mbani parasysh udhëzimet e sigurisë nëse në shtëpinë tuaj jetojnë fëmijë.

⚠ PARALAJMËRIM – Rrezik asfiksioni!

- Fëmijët mund të fusin në kokë ose të mbështillen me materialin e paketimit dhe për rrjedhojë të mbyten.
 - ▶ Mbani larg fëmijëve materialin e paketimit.
 - ▶ Mos i lini fëmijët të luajnë me materialin e paketimit.
- Fëmijët mund të thithin ose të gëlltitin pjesë të vogla dhe për rrjedhojë të mbyten.
 - ▶ Mbani pjesët e vogla larg nga fëmijët.
 - ▶ Mos lejoni fëmijët të luajnë me pjesët e vogla.

⚠ PARALAJMËRIM – Rrezik dëmsh në shëndet!

Fëmijët mund të bllokohen brenda në pajisje dhe të rrezikojnë jetën.

- ▶ Në pajisjet që nuk janë në gjendje pune, hiqni spinën e kordonit elektrik, më pas pritni komplet kordonin elektrik dhe dëmtoni bravën e derës së pajisjes deri në atë pikë sa të mos mbyllet më.

⚠ PARALAJMËRIM – Rrezik shtypjeje!

Në pajisjet inkaso të integruara lart fëmijët mund të ngecin midis derës së pajisjes dhe dyerve të dollapit që gjenden poshtë tyre.

- ▶ Gjatë hapjes dhe mbylljes së derës së pajisjes kini kujdes fëmijët.

⚠ PARALAJMËRIM – Rrezik djegjesh kimike!

Shkëlqyesi i enëve dhe detergjenti mund të shkaktojnë irritime të gojës, fytit dhe të syve.

- ▶ Mbani fëmijët larg nga produktet e shkëlqimit të enëve dhe detergjentet.
- ▶ Mbani fëmijët larg nga pajisja e hapur. Uji në hapësirën e brendshme të larjes nuk është ujë i pijshëm. Ai mund të ketë brenda mbetje detergjenti dhe shkëlqyesi enësh.

⚠ PARALAJMËRIM – Rrezik lëndimi!

Fëmijët mund të ngecin gishtat e tyre të vegjël në të çarat e kutisë mbajtëse të tabletës dhe të lëndohen.

- ▶ Mbani fëmijët larg nga pajisja e hapur.

⚠ PARALAJMËRIM – Rrezik asfiksimi!

Fëmijët mund të mbyllen brenda në pajisje dhe të mbyten.

- ▶ Përdorni siguresën për fëmijët, nëse ka.
- ▶ Mos i lejoni kurrë fëmijët të luajnë ose të përdorin pajisjen.

Sistemet e sigurisë

Mbroni fëmijët nga rreziqet, të cilat mund të krijohen nga pajisja.

Në varësi të pajimit të variantit të pajisjes kjo disponon një

→ "Siguresa për fëmijët", Faqe 12.

Shmangia e dëmeve materiale

Instalimi i sigurt

Mbani parasysh udhëzimet gjatë instalimit të pajisjes.

VINI RE!

- Instalimet e papërshtatshme të pajisjes mund të shkaktojnë dëmtime.
 - ▶ Kur enëlarësja montohet poshtë apo sipër pajisjeve të tjera shtëpiake, atëherë ndiqni informacionet për montimin në kombinim me enëlarësen në manualin e montimit të pajisjeve shtëpiake përkatëse.
 - ▶ Nëse nuk ka asnjë informacion ose nëse manuali i montimit nuk ka asnjë udhëzim përkatës, atëherë duhet pyetur te prodhuesi i këtyre pajisjeve shtëpiake, për t'u siguruar që enëlarësja mund të instalohet sipër ose poshtë pajisjeve të tjera shtëpiake.
 - ▶ Nëse nuk ka asnjë informacion në dispozicion nga prodhuesi, atëherë enëlarësja nuk duhet montuar sipër ose poshtë këtyre pajisjeve shtëpiake.
 - ▶ Gjithashtu, për të siguruar funksionimin e sigurt të të gjitha pajisjeve shtëpiake mbani parasysh manualin e montimit të enëlarëses.
 - ▶ Mos e instaloni enëlarësen poshtë një plani gatimi.
 - ▶ Mos e instaloni enëlarësen në afërsi të burimeve të nxehtësisë, p.sh. rezistencë, akumulator nxehtësie, sobë ose pajisje tjetër, të cilat prodhojnë nxehtësi.

- Tubat e ujit që ndryshohen ose janë të dëmtuar mund të shkaktojnë dëme materiale dhe dëmtime të pajisjes.
 - ▶ Asnjëherë mos i përthyeri, mos i shtypni, mos i ndryshoni ose mos i pritni tubat e ujit.
 - ▶ Përdorni vetëm tubat e ujit të ofruar me pajisjen ose vetëm tuba zëvendësues origjinalë.
 - ▶ Asnjëherë mos ripërdorni tuba uji të konsumuar.
- Presioni shumë i ulët ose shumë i lartë i ujit mund të ndikojë në funksionimin e pajisjes.
 - ▶ Sigurohuni që presioni i ujit në rrjetin e furnizimit me ujë të jetë të paktën 50 kPa (0,5 bar) dhe maksimumi 1000 kPa (10 bar).
 - ▶ Kur presioni i ujit e tejkalon vlerën maksimale të treguar më lart, midis lidhjes së rrjetit të ujit dhe grupit të tubit të pajisjes duhet instaluar një valvul reduktuese e presionit.

Përdorimi i sigurt

Mbani parasysh udhëzimet gjatë përdorimit të pajisjes.

VINI RE!

- Çlirimi i avullit të ujit mund të dëmtojë mobilet e instalimit.
 - ▶ Lëreni pajisjen të ftohet pak pas përfundimit të programit përpara hapjes së derës së pajisjes.
- Kripa e veçantë mund ta dëmtojë kazanin e larjes nëpërmjet korrozionit.
 - ▶ Në mënyrë që kripa e veçantë e derdhur të shpëlahet nga kazanin e larjes, hidhni kripën e veçantë direkt në enën rezervë përpara nisjes së programit.

sq Siguresa për fëmijët

- Detergjenti mund të dëmtojë sistemin e zbutjes së ujit.
 - ▶ Mbushni enën rezervë të sistemit të zbutjes së ujit vetëm me kripë të veçantë për enëlarëse.
- Produktet e papërshtatshme të pastrimit mund të dëmtojnë pajisjen.
 - ▶ Mos përdorni pastrues me avull.
 - ▶ Për të mos gërvishtur sipërfaqen e pajisjes, mos përdorni asnjë sfungjer me sipërfaqe të ashpër dhe asnjë produkt pastrimi gërryes.
 - ▶ Për të shmangur korrozionin, te enëlarëset me pjesë të përpame prej inoksi mos përdorni asnjë sfungjer të ashpër ose shpëlajeni atë disa herë me kujdes përpara përdorimit të parë.

Siguresa për fëmijët¹

Me siguresën për fëmijët ju mbron fëmijët nga rreziqet që mund të krijohen nga pajisja. Në varësi të pajimit të variantit të pajisjes kjo disponon një bllokim të derës.

Bllokimi i derës

Bllokimi i derës është një sistem mekanik i sigurisë dhe pengon hapjen e derës së pajisjes. Ju mund ta aktivizoni ose ta çaktivizoni bllokimin e derës.

⚠ PARALAJMËRIM Rrezik asfiksimi!

Fëmijët mund të mbyllen brenda në pajisje dhe si rezultat të mbyten.


- ▶ Aktivizoni bllokimin e derës dhe mbyllni derën e pajisjes.

→ "Hapja e derës së pajisjes", Faqe 39

Aktivizimi i bllokimit të derës

Shënim Bllokimi i derës mbetet i aktivizuar derisa ai të çaktivizohet manualisht.

1. Hapni derën e pajisjes.
2. Tërhiqni përpara gjuhëzën e siguresës për fëmijët ① dhe mbyllni derën e pajisjes ②.




Çaktivizimi i bllokimit të derës

1. Hapni derën e pajisjes.

¹ Sipas pajimit të pajisjes

2. Shtypni djathtas gjuhëzën e siguresës për fëmijët ① dhe shtyjeni nga prapa ②.



3. Mbyllni derën e pajisjes.

Mbrojtja e mjedisit dhe kursimi

Mbroni mjedisin duke e përdorur pajisjen në mënyrë ekonomike dhe duke i hedhur në mënyrën e duhur materialet e riciklueshme.

Hedhja e paketimit

Materialet e paketimit janë pro mjedisore dhe të riciklueshme.

- ▶ Hidhni pjesët e caktuara të seleksionuara sipas llojit.
Informacione për mënyrat aktuale të hedhjes mësoni te shitësi dhe tek administrata lokale e komunës ose qytetit.

Kursimi i energjisë

Nëse i ndiqni këto udhëzime, pajisja juaj harxhon më pak energji elektrike dhe më pak ujë.

Përdorni programin Eco 50°.

- + Programi Eco 50° kursen energji dhe është miqësor me mjedisin.
→ "Programet", Faqe 19

Nëse keni vetëm pak enë për të larë, atëherë përdorni funksionin shtesë të gjysmës së ngarkesës.¹

- + Programi përshtatet me ngarkesën e ulët dhe vlerat e konsumit reduktohen.
→ "Funksionet shtesë", Faqe 21

Tharja me zeolit ndihmon automatikisht për të kursyer energji.

- + → "Tharja me zeolit ☉", Faqe 13

Tharja me zeolit ☉

Pajisja është e pajisur me një enë zeoliti. Me tharjen me zeolit mund të kursehet energji.

Zeoliti është një mineral që mund të ruajë dhe të japë sërish lagështirën dhe energjinë e ngrohtësisë.

Në hapin e pastrimit përdoret energjia e ngrohtësisë për të nxehur ujin e larjes dhe për të tharë mineralin.

Gjatë fazës së tharjes ruhet lagështira nga hapësira e brendshme e larjes në mineral dhe çlirohet energjia e ngrohtësisë. Energjia e ngrohtësisë fryhet në hapësirën e brendshme të larjes me ajër të thatë. Nga kjo është e mundur një tharje e shpejtë dhe e përmirësuar. Në këtë mënyrë tharja me zeolit kursen shumë energji.

¹ Sipas pajimit të pajisjes

Këshillë Për të mos ulur aftësinë e funksionit të tharjes me zeolit, mos vendosni asnjë pjesë të enëve direkt përpara vrimës së thithjes dhe të fryrjes së enës prej zeoliti.

Mos vendosni asnjë pjesë të enëve të ndjeshme ndaj temperaturës direkt përpara vrimës së fryrjes së enës prej zeoliti.

→ "Pajisja", Faqe 16

Sensori i ujit¹

Sensori i ujit është një pajisje matëse optike (sensor fotoelektrik) me të cilën matet turbullira e ujit të larjes. Me sensorin i ujit mund të kursehet ujë.

Përdorimi i sensorit i ujit bëhet specifik sipas programit. Nëse ndotja është e ulët, atëherë uji i larjes kalohet në procesin e radhës së larjes dhe konsumi i ujit mund të ulet me 3-6 litra. Nëse ndotja është më e lartë, atëherë uji i larjes pompohet jashtë dhe zëvendësohet nga uji i pastër. Në programet automatike temperatura dhe kohëzgjatja përshtaten sipas shkallës së ndotjes.

Instalimi dhe lidhja

Përmbajtja e paketimit

Pas nxjerrjes nga paketimi kontrolloni të gjitha pjesët për dëmtime nga transporti dhe për plotësinë e dërgesës.

Në rast ankesash drejtohuni te shitësi ku keni blerë pajisjen ose te shërbimi ynë për klientin.

Shënim Pajisja është kontrolluar në fabrikë për funksionin e saj të përsosur. Për këtë arsye në pajisje

mund të kenë mbetur njolla uji. Njollat e ujit ikin pas procesit të parë të larjes.

Paketimi përbëhet nga:

- Enëlarësja
- Udhëzuesi i përdorimit
- Udhëzuesi i montimit
- Garancia¹
- Materiali i montimit
- Llamarina e mbrojtjes nga avulli¹
- Paneli prej gome¹
- Kablloja elektrike
- Udhëzues i shkurtër¹

Instalimi dhe lidhja e pajisjes

Ju mund ta instaloni pajisjen tuaj nën banak ose pajisjen inkaso në vargun e dollapëve të kuzhinës midis mureve të drurit dhe mureve plastike. Nëse më pas e vendosni pajisjen tuaj si njësi të pavarur, atëherë duhet ta siguronit pajisjen tuaj ndaj rrëzimit, p.sh. duke e vidhosur në mur ose duke e montuar nën një plan pune të pandërprerë, i cili është i lidhur mirë me dollapët ngjitur.

1. "Mbani parasysh udhëzimet e sigurisë." → Faqe 4
2. "Mbani parasysh udhëzimet për lidhjen elektrike." → Faqe 15
3. Kontrolloni "përmbajtjen e paketimit" → Faqe 14 dhe gjendjen e pajisjes.
4. Merrni përmasat e nevojshme të instalimit nga manuali i montimit.
5. Vendosni horizontalisht pajisjen me ndihmën e këmbëve me rregullim. Bëni kujdes për qëndrimin e sigurt.
6. "Instaloni lidhjen e tubit shkarkues të ujit." → Faqe 15
7. "Instaloni lidhjen e ujit të pijshëm." → Faqe 15

¹ Sipas pajimit të pajisjes

- Lidhni pajisjen me energjinë elektrike.

Lidhja e tubit shkarkues të ujit

Lidhni pajisjen tuaj në një tub shkarkues, në mënyrë që të rrjedhë jashtë uji i ndotur nga procesi i larjes.

Instalimi i tubit shkarkues të ujit

- Shihni hapat e nevojshëm të manuali të montimit të dërguar me pajisjen.
- Lidhni zorrën e shkarkimit në vrimën e shkarkimit në sifon me ndihmën e pjesëve të dërguara.
- Bëni kujdes që tubi i shkarkimit të mos përthyeret, të mos shtypet ose të mos përdridhet.
- Bëni kujdes që asnjë kapak i mbylljes në shkarkim të mos pengojë rrjedhën e ujit të ndotur.

Lidhja me rrjetin e ujit të pijshëm

Lidhni pajisjen tuaj në një lidhje të ujit të pijshëm.

Instalimi i lidhjes në rrjetin e ujit të pijshëm

Shënim

- Nëse e ndërroni pajisjen, atëherë duhet të përdorni një tub të ri për furnizimin me ujë.
- Shihni hapat e nevojshëm të manuali të montimit të dërguar me pajisjen.
 - Lidhni pajisjen në lidhjen e rrjetit të ujit të pijshëm me ndihmën e pjesëve të dërguara.
Mbani parasysh "të dhënat teknike" → *Faqe 63*.
 - Bëni kujdes që lidhja me rrjetin e ujit të pijshëm të mos përthyeret, të mos shtypet ose të mos përdridhet.

Lidhja elektrike

Lidhni pajisjen tuaj në rrjetin e energjisë elektrike.

Lidhja elektrike e pajisjes


Shënime

- Mbani parasysh "udhëzimet e sigurisë" → *Faqe 5*.
 - Lidhni pajisjen vetëm në energji elektrike në diapazonin 220 - 240 V dhe 50 Hz ose 60 Hz.
 - Mbani parasysh që sistemi i sigurisë së ujit funksionon vetëm kur ka furnizim me energji elektrike.
- Fusni në pajisje spinën e kabllos bashkuese të kordonit elektrik.
 - Fusni spinën e kordonit elektrik të pajisjes në një prizë në afërsi të pajisjes.
Të dhënat e lidhjes së pajisjes jepen në etiketën e parametrave.
 - Kontrolloni spinën e kordonit elektrik për qëndrimin e palëvizshëm.

Njohja

Pajisja

Këtu gjeni një pasqyrë përmbledhëse të pjesëve përbërëse të pajisjes.



1

Etiketa e parametrave

Etiketa e parametrave me "numrin E dhe numrin FD"
→ Faqe 63.
Të dhënat ju nevojiten për "shërbimin e klientit"
→ Faqe 62.

¹ Sipas pajimit të pajisjes


| | | |
|-----------|---|--|
| 2 | Kutia për detergjentin | Hidhni "detergjentin" → <i>Faqe 34</i> në kutinë për detergjentin. |
| 3 | Koshi i poshtëm i enëve | "Koshi i poshtëm i enëve" → <i>Faqe 24</i> |
| 4 | Sistemi i filtrave sitë | "Sistemi i filtrave sitë" → <i>Faqe 45</i> |
| 5 | Krahu i poshtëm i spërkatjes | Krahu i poshtëm i spërkatjes pastron enët në koshin e poshtëm të enëve. Nëse enët nuk pastrohet në mënyrë optimale, atëherë pastroni krahët e spërkatjes. → <i>"Pastrimi i krahëve të spërkatjes", Faqe 46</i> |
| 6 | Ena mbajtëse për kripën e veçantë | Në enën mbajtëse për kripë të veçantë hidhni kripën e veçantë për "sistemin e zbutjes së ujit" → <i>Faqe 29</i> . |
| 7 | Kutia mbajtëse e tabletës | Gjatë procesit të larjes tabletat bien automatikisht nga kutia e detergjentit në kutinë mbajtëse të tabletës, ku ato mund të treten në mënyrë optimale. |
| 8 | Koshi i sipërm i enëve | "Koshi i sipërm i enëve" → <i>Faqe 23</i> |
| 9 | Sirtari i takëmeve të ngrënies ¹ | "Sirtari i takëmeve të ngrënies" → <i>Faqe 25</i> |
| 10 | EmotionLight ¹ | Ndriçimi i brendshëm i pajisjes. → <i>"Pamja e përgjithshme e cilësimeve bazë", Faqe 42</i> |
| 11 | Rafti me palosje | "Rafti me palosje" → <i>Faqe 26</i> |
| 12 | Krahët e sipërm të spërkatjes | Krahët e sipërm të spërkatjes pastrojnë enët në koshin e sipërm të enëve. Nëse enët nuk pastrohet në mënyrë optimale, atëherë pastroni krahët e spërkatjes. → <i>"Pastrimi i krahëve të spërkatjes", Faqe 46</i> |
| 13 | Vrima e thithjes e enës prej zeoliti | Vrima e thithjes nevojitet për "tharjen me zeolit" → <i>Faqe 13</i> . |
| 14 | Vrima e fryrjes e enës prej zeoliti | Vrima e fryrjes nevojitet për "tharjen me zeolit" → <i>Faqe 13</i> . |
| 15 | Koshi për takëmet e ngrënies ¹ | "Koshi për takëmet e ngrënies" → <i>Faqe 25</i> |
| 16 | Kutia mbajtëse e shkëlqyesit të enëve | Hidhni shkëlqyesin në kutinë mbajtëse të tij për "sistemin e shkëlqyesit të enëve" → <i>Faqe 32</i> . |

¹ Sipas pajimit të pajisjes

Elementet e përdorimit

Përmes elementeve të komandimit ju aktivizoni të gjitha funksionet e pajisjes dhe merrni informacion për gjendjen e funksionimit.

Ju mund të ekzekutoni funksione të ndryshme me disa butona.



| | | |
|-----------|--|--|
| 1 | Butoni i ndezjes/fikjes ① | "Ndezja e pajisjes" → Faqe 39 "Fikja e pajisjes" → Faqe 41 |
| 2 | Butonat e programit | "Programet" → Faqe 19 |
| 3 | Treguesi i furnizimit me ujë | "Treguesi për furnizimin me ujë ndriçon" → Faqe 49 |
| 4 | Treguesi i rimbushjes me kripë të veçantë | "Sistemi i zbutjes së ujit" → Faqe 29 |
| 5 | Treguesi për rimbushjen me shkëlqyes enësh | "Sistemi i shkëlqyesit të enëve" → Faqe 32 |
| 6 | Butonat e programit dhe funksionet shtesë | "Programet" → Faqe 19 "Funksionet shtesë" → Faqe 21 |
| 7 | Butoni Start Start dhe butoni Reset Reset 3 sec. | "Nisja e programit" → Faqe 40 "Ndërprerja e programit" → Faqe 40 |
| 8 | Zgjedhja e kohës | "Vendosja e përzgjedhjes së kohës" → Faqe 40 |
| 9 | Hapësi i derës ¹ | "Hapni derën e pajisjes." → Faqe 39 |
| 10 | Ekran | Ekran ju tregon informacione për kohëzgjatjen e mbetur ose cilësimet bazë. Nëpërmjet ekranit dhe butonave të rregullimit mund të ndryshoni cilësimet bazë. → "Ndryshimi i cilësimeve bazë", Faqe 43 |





¹ Sipas pajimit të pajisjes








Programet









Këtu gjeni një pasqyrë rreth programeve të rregullueshme. Në varësi të konfigurimit të pajisjes janë të disponueshme programe të ndryshme, të cilat i gjeni në panelin e kontrollit të pajisjes suaj.

Në varësi të programit të zgjedhur kohëzgjatja mund të ndryshojë. Kohëzgjatja varet nga temperatura e ujit, sasia e enëve, shkalla e ndotjes dhe "funksioni shtesë" → *Faqe 21* i

zgjedhur. Kur sistemi i shkëlqyesit të enëve është i fikur ose kur nuk ka shkëlqyes, kohëzgjatja ndryshon. Vlerat e konsumit i gjeni në manualin e shkurtër udhëzues. Vlerat e konsumit u referohen kushteve normale dhe vlerës së fortësisë së ujit 13 - 16 °dH. Faktorët e ndryshëm ndikues mund të shkaktojnë devijime, p.sh. temperatura e ujit ose presioni i ujit nga tubacioni.

| Programi | Përdorimi | Ecuria e programit | Funksionet shtesë |
|--|--|--|---|
|   Intensiv 70° | Enët: <ul style="list-style-type: none"> ■ Për pastrimin e tenxhereve, tiganëve, enëve dhe takëmeve jo delikate të ngrënies. Shkalla e ndotjes: <ul style="list-style-type: none"> ■ Hiqni mbetjet e ushqimit të ngjitura fort, të djegur, të thara, me përmbajtje të fortë niseshteje ose albumine. Gjatë përdorimit të detergjentit pluhur ju mund të hidhni pak detergjent shtesë në derën e brendshme të pajisjes. | Intensiv: <ul style="list-style-type: none"> ■ Paralarja ■ Pastrimi 70°C ■ Shpëlarja e ndërmjetme ■ Shpëlarja 50°C ■ Tharja | Të gjitha → "Funksionet shtesë", <i>Faqe 21</i> |
|   Auto 45°-65° | Enët: <ul style="list-style-type: none"> ■ Për pastrimin e enëve të përziara dhe të takëmeve të ngrënies. Shkalla e ndotjes: <ul style="list-style-type: none"> ■ Hiqni mbetjet e zakonshme të ushqimit të thara lehtë. | Përshtatur nga sensori: <ul style="list-style-type: none"> ■ Përshtatet në varësi të ndotjes së ujit të larjes nëpërmjet sistemit të sensorëve. | Të gjitha → "Funksionet shtesë", <i>Faqe 21</i> |

| Programi | Përdorimi | Ecuria e programit | Funksionet shtesë |
|---|---|---|--|
|   Eco 50° | Enët: <ul style="list-style-type: none"> ■ Për pastrimin e enëve të përziera dhe të takëmeve të ngrënies. Shkalla e ndotjes: <ul style="list-style-type: none"> ■ Hiqni mbetjet e zakonshme të ushqimit të thara lehtë. | Programi më ekonomik: <ul style="list-style-type: none"> ■ Paralarja ■ Pastrimi 50°C ■ Shpëlarja e ndërmjetme ■ Shpëlarja 35°C ■ Tharja | Të gjitha → "Funksionet shtesë", Faqe 21 |
|  Silence Pa zhurmë 50° | Enët: <ul style="list-style-type: none"> ■ Për pastrimin e enëve të përziera dhe të takëmeve të ngrënies. Shkalla e ndotjes: <ul style="list-style-type: none"> ■ Hiqni mbetjet e zakonshme të ushqimit të thara lehtë. | Përshtatur kundër zhurmës: <ul style="list-style-type: none"> ■ Paralarja ■ Pastrimi 50°C ■ Shpëlarja e ndërmjetme ■ Shpëlarja 35°C ■ Tharja | IntensivZone Mbushje e gjysmë HigjienaPlus Tharja ekstra Tharja me shkëlqim → "Funksionet shtesë", Faqe 21 |
|   Qelq 40° | Enët: <ul style="list-style-type: none"> ■ Për pastrimin e enëve dhe të takëmeve delikate të ngrënies, të plastikave të ndjeshme ndaj temperaturës, të gotave dhe gotave me fron në koshin për gotat me fron. Shkalla e ndotjes: <ul style="list-style-type: none"> ■ Hiqni mbetjet e freskëta të ushqimit që janë pak të ngjitura. | Veçanërisht delikat: <ul style="list-style-type: none"> ■ Paralarja ■ Pastrimi 40°C ■ Shpëlarja e ndërmjetme ■ Shpëlarja 50°C ■ Tharja | IntensivZone VarioSpeedPlus Mbushje e gjysmë Tharja ekstra Tharja me shkëlqim → "Funksionet shtesë", Faqe 21 |
|   I shpejtë 65° | Enët: <ul style="list-style-type: none"> ■ Për pastrimin e enëve të përziera dhe të takëmeve të ngrënies. Shkalla e ndotjes: <ul style="list-style-type: none"> ■ Hiqni mbetjet e zakonshme të ushqimit të thara lehtë. | Përshtatur sipas kohës: <ul style="list-style-type: none"> ■ Pastrimi 65°C ■ Shpëlarja e ndërmjetme ■ Shpëlarja - °C ■ Tharja | Tharja ekstra Tharja me shkëlqim → "Funksionet shtesë", Faqe 21 |

| Programi | Përdorimi | Ecuria e programit | Funksionet shtesë |
|--|--|---|--|
|    I shkurtër 60° | Enët: <ul style="list-style-type: none"> ■ Për pastrimin e enëve të përziera dhe të takëmeve të ngrënies. Shkalla e ndotjes: <ul style="list-style-type: none"> ■ Hiqni mbetjet e zakonshme të ushqimit të thara lehtë. | Përshtatur sipas kohës: <ul style="list-style-type: none"> ■ Pastrimi 65°C ■ Shpëlarja e ndërmjetme ■ Shpëlarja 50°C ■ Tharja | Të gjitha → "Funksionet shtesë", Faqe 21 |
|   I shpejtë 45° | Enët: <ul style="list-style-type: none"> ■ Pastroni enët dhe takëmet delikate të ngrënies, plastikën e ndjeshme të temperaturës dhe gotat. Shkalla e ndotjes: <ul style="list-style-type: none"> ■ Hiqni mbetjet e freskëta të ushqimit që janë pak të ngjitura. | Përshtatur sipas kohës: <ul style="list-style-type: none"> ■ Pastrimi 45°C ■ Shpëlarja e ndërmjetme ■ Shpëlarja 50°C | Tharja ekstra Tharja me shkëlqim → "Funksionet shtesë", Faqe 21 |
|   Para shpëlarje | Enët: <ul style="list-style-type: none"> ■ Pastroni të gjitha llojet e enëve. Shkalla e ndotjes: <ul style="list-style-type: none"> ■ Shpëlarje me ujë të ftohtë, pastrim i ndërmjetëm. | Shpëlarje me ujë të ftohtë: <ul style="list-style-type: none"> ■ Paralarja | S'ka |
|  Mirëmbajtja e enëlarëses | - | Mirëmbajtja e pajisjes 70°C | S'ka |

Udhëzime për institutet e testimit

Institutet e testeve marrin udhëzime për testet krahasuese, për shembull sipas EN60436. Këtu bëhet fjalë për kushtet për kryerjen e testeve, por jo për rezultatet ose vlerat e konsumit. Për pyetje dërgoni email te: dishwasher@test-appliances.com




Nevojitet numri i produktit (E-Nr.) dhe numri i prodhimit (FD), të cilët gjenden në etiketën e parametrevë në derën e pajisjes.




Funksionet shtesë

Këtu gjeni një pasqyrë rreth funksioneve shtesë të rregullueshme. Në varësi të konfigurimit të pajisjes

sq Funksionet shtesë

janë të disponueshme funksione shtesë të ndryshme, të cilat i gjeni në panelin e kontrollit të pajisjes suaj.

| Funksionet shtesë | Përdorimi |
|--|---|
|  VarioSpeedPlus | <ul style="list-style-type: none">■ Në varësi të programit të larjes kohëzgjatja shkurtohet me rreth 20% deri 66%.■ Konsumi i ujit dhe i energjisë rritet. |
|  Mbushje e gjysmë | <ul style="list-style-type: none">■ Kaloni te pak enë.■ Hidhni më pak detergjent në kutinë e detergjentit, nga sa rekomandohet për një ngarkesë të plotë të pajisjes.■ Kohëzgjatja shkurtohet.■ Konsumi i ujit dhe i energjisë reduktohet. |
|  HigjienaPlus | <ul style="list-style-type: none">■ Për të ruajtur një nivel të lartë higjiene të pajisjes dhe të enëve, temperatura rritet dhe mbahet tepër gjatë.■ Veçanërisht i përshtatshëm për pastrimin e pllakave të prerjes dhe shisheve për foshnja.■ Nëpërmjet përdorimit të vazhdueshëm të këtij funksioni arrihet një nivel më i lartë higjienik.■ Nga kjo rritet kohëzgjatja dhe shtohet konsumi i energjisë. |


| Funksionet shtesë | Përdorimi |
|---|--|
|  IntensivZone | <ul style="list-style-type: none">■ Kaloni te ngarkesa e përzier me enë me ndotje të forta dhe të dobët, p.sh. tenxheret dhe tiganët me ndotje më të fortë vendosini në koshin e poshtëm dhe enët me ndotje normale në koshin e sipërm.■ Presioni i spërkatjes në koshin e poshtëm rritet dhe temperatura maksimale e programit ruhet më e gjatë. Nga kjo rritet kohëzgjatja dhe shtohet konsumi i energjisë. |
|  Tharja ekstra | <ul style="list-style-type: none">■ Për një rezultat të përmirësuar të tharjes rritet temperatura e shpërlarjes me shkëlqyes enësh dhe zgjatet faza e tharjes.■ Veçanërisht i përshtatshëm për tharjen e pjesëve plastike.■ Konsumi i energjisë rritet paksa dhe zgjatet koha e punës. |
|  Tharja me shkëlqim | <ul style="list-style-type: none">■ Për të shmangur njollat dhe për të përmirësuar tharjen rritet sasia e ujit dhe zgjatet faza e tharjes.■ Konsumi i energjisë rritet.■ Përdorni shkëlqyes. |

Pajisja

Këtu gjeni një pamje të përgjithshme rreth pajimit të mundshëm të pajisjes suaj dhe përdorimit të saj. Pajimi varet nga varianti i pajisjes suaj.

Koshi i sipërm i enëve

Sistemoni filxhanët dhe gotat në koshin e sipërm të enëve.



Rafti i thikave ^a


Për të ruajtur vendin për enë të mëdha, ju mund të zhvendosni në lartësi koshin e sipërm të enëve.

Rregullimi i koshit të sipërm të enëve me leva anësore

Për të larë pjesë të mëdha enësh në koshat e enëve, rregulloni lartësinë e koshit të sipërm të enëve.


1. Tërhiqni jashtë koshin e sipërm të enëve.
2. Për të shmangur një rënie poshtë të koshit të enëve, mbani fort anash koshin e enëve në skajin e sipërm.

3. Shtypni nga brenda levën majtas dhe djathtas në anën e jashtme të koshit të enëve.



Koshi i enëve mund të ulet paksa.

4. Uleni ose ngrijeni njëtrajtësisht koshin e enëve në shkallën e përshtatshme.
→ "Lartësitë e koshit të enëve", Faqe 28



Sigurohuni që koshi i enëve të qëndrojë në lartësi të njëjtë në të dyja anët.

5. Shtyni brenda koshin e enëve.


Rregullimi i koshit të sipërm të enëve me çiftet e ruleve

Për të larë pjesë të mëdha enësh në koshat e enëve, rregulloni lartësinë e koshit të sipërm të enëve.


1. Tërhiqni jashtë koshin e sipërm të enëve.

¹ Sipas pajimit të pajisjes

2. Hiqni koshin e enëve.



3. Varni koshin e enëve në lartësinë e përshtatshme të koshit të enëve.
→ "Lartësitë e koshit të enëve",
Faqe 28




Sigurohuni që koshi i enëve të qëndrojë në lartësi të njëjtë në të dyja anët.

4. Shtyni brenda koshin e enëve.


Koshi i poshtëm i enëve

Sistemoni tenxheret dhe pjatat në koshin e poshtëm të enëve.



Koshi për takëmet e ngrënies ^a


Ju mund t'i vendosni pjatat e mëdha me diametër deri në 31/34 cm ¹ siç tregohet.



¹ Sipas pajimit të pajisjes


Koshi për takëmet e ngrënies

Sistemoni takëmet e ngrënies në koshin e takëmeve të ngrënies gjithmonë në mënyrë të pa seleksionuar dhe me majat për poshtë.



Sirtari i takëmeve të ngrënies

Sistemoni takëmet e ngrënies në sirtarin e takëmeve të ngrënies.




Sistemoni takëmet e ngrënies me majë dhe anë të mprehta për poshtë. Për të ruajtur më shumë hapësirë për pjesë më të larta dhe më të gjera të takëmeve, mund të rindërtoni sirtarët e takëmeve.¹

Konvertimi i sirtarit të takëmeve të ngrënies¹


Për të ruajtur më shumë hapësirë për pjesë më të larta dhe më të gjera të takëmeve, ju mund t'i ulni raftet anësore dhe të palosni rreshtat e përparmë të telave.

1. Për të ulur raftin anësor, shtyni përpara levën ① dhe ulni raftin anësor ②.
2. Për të palosur rreshtat e përparmë të majave, shtyni përpara levën dhe palosni telat ③.



Këshillë


Nëse doni ta ktheni sirtarin e takëve të ngrënies në pozicionin fillestar, atëherë mbërtheni sirtarin anësor nga sipër, derisa ky të mbyllet me kërcitje të dëgjueshme.



¹ Sipas pajimit të pajisjes

Rafti me palosje

Përdorni raftin me palosje dhe hapësirën poshtë, për të sistemuar filxhanë të vegjël dhe gota ose takëme të mëdha ngrënieje, p.sh. lugë druri për gatim ose takëme shërbimi.




Ju mund të vendosni lartësinë e raftit me palosje.¹

Nëse nuk ju nevojitet rafti me palosje, atëherë mund ta palosni atë nga sipër.

Rregulloni raftin me palosje¹

Ju mund ta zhvendosni në lartësi raftin me palosje.


1. Vendoseni vertikalisht raftin me palosje dhe tërhiqeni nga sipër ①.



2. Vendoseni pak pjerrtas raftin me palosje dhe shtyjeni në lartësinë e përshtatshme ②.
 3. Shtyni nga poshtë raftin me palosje.
- ✓ Rafti me palosje mbyllet me kërcitje të dëgjueshme.

Telat mbajtës me palosje

Përdorni telat mbajtës me palosje, për të renditur enët, p.sh. pjatat.




Për të sistemuar më mirë tenxheret, tasat dhe gotat, ju mund të palosni telat mbajtës me palosje.¹

Palosni telat mbajtës me palosje¹

Nëse nuk ju nevojiten telat mbajtës me palosje, atëherë palosini ato.

¹ Sipas pajimit të pajisjes


1. Shtyni përpara levën ① dhe palosni telat mbajtës me palosje ②.



2. Për të përdorur sërish telat mbajtës me palosje, palosini ato lart.
 - ✓ Telat mbajtës me palosje mbyllen me kërcitje të dëgjueshme.


Mbajtësja e pjesëve të vogla

Përdorni mbajtësen e gjërave të vogla për të sistemuar pjesët e vogla të enëve, p.sh. pjesë të lehta plastike.




Ndarja e thikave

Përdorni ndarjen e thikave për sende të gjata, të mprehta dhe për copa të gjata të takëmeve të ngrënies.



Koka spërkatëse për tavat e pjekjes

Përdorni kokën spërkatëse për tavat e pjekjes për të pastruar enë të mëdha, p.sh. tava, skara dhe pjata.




Në mënyrë që rryma spërkatëse të arrijë të gjitha pjesët, vendosni maksimumi 2 tava dhe 2 skara siç tregohet në figurë.

Shënim Mbani parasysh që ta përdorni pajisjen gjithmonë me koshin e sipërm të enëve ose me kokën spërkatëse për tavat e pjekjes.

Vendosja e kokës spërkatëse për tavat e pjekjes

Vendosni kokën spërkatëse për tavat e pjekjes në vend të koshit të sipërm të enëve për të pastruar tava të mëdha, skara dhe pjata.

1. Hiqni koshin e sipërm të enëve.
2. Vendoseni kokën spërkatëse për tavat e pjekjes te mbajtësja ① dhe rrotullojeni djathtas ②.



- ✓ Koka spërkatëse për tavat e pjekjes mbyllet me kërcitje të dëgjueshme.

Lartësitë e koshit të enëve

Vendoseni shportën për enë në lartësi të përshtatshme.

Lartësia e pajisjes 81,5 cm me shportën e takëmeve të ngrënies

| Niveli | Shporta e sipërme | Shporta e poshtme |
|-----------|-------------------|-------------------|
| 1 maks. ø | 22 cm | 31 cm |
| 2 maks. ø | 24,5 cm | 27,5 cm |
| 3 maks. ø | 27 cm | 25 cm |

Lartësia e pajisjes 81,5 cm me sirtarin e takëmeve të ngrënies

| Niveli | Shporta e sipërme | Shporta e poshtme |
|-----------|-------------------|-------------------|
| 1 maks. ø | 16 cm | 31 cm |
| 2 maks. ø | 18,5 cm | 27,5 cm |
| 3 maks. ø | 21 cm | 25 cm |

Heqja e kokës spërkatëse për tavat e pjekjes

Nëse koka spërkatëse për tavat e pjekjes nuk ju nevojitet më, atëherë hiqeni atë nga pajisja.

1. Rrotulloni majtas kokën spërkatëse për tavat e pjekjes dhe nxirreni nga mbajtësja.
2. Vendosni në pajisje koshin e sipërm të enëve.

Lartësia e pajisjes 86,5 cm me shportën e takëmeve të ngrënies

| Niveli | Shporta e sipërme | Shporta e poshtme |
|-----------|-------------------|-------------------|
| 1 maks. ø | 24 cm | 34 cm |
| 2 maks. ø | 26,5 cm | 30,5 cm |
| 3 maks. ø | 29 cm | 28 cm |

Lartësia e pajisjes 86,5 cm me sirtarin e takëmeve të ngrënies

| Niveli | Shporta e sipërme | Shporta e poshtme |
|-----------|-------------------|-------------------|
| 1 maks. ø | 18 cm | 34 cm |
| 2 maks. ø | 20,5 cm | 30,5 cm |
| 3 maks. ø | 23 cm | 28 cm |

Përpara përdorimit për herë të parë

Kryeni rregullimet e nevojshme për vënien në përdorim për herë të parë.

Vënia në përdorim për herë të parë

Në rastin e përdorimit të parë ose pas rivendosjes në cilësimet e fabrikës ju duhet të bëni cilësimet.

Kërkesë: "Pajisja është e ngritur dhe e lidhur." → *Faqe 14*

1. "Mbushni me kripë të veçantë." → *Faqe 30*
2. "Mbushni shpëlarësin." → *Faqe 32*
3. "Ndizni pajisjen." → *Faqe 39*

4. "Vendosja e sistemit të zbutjes me ujë." → *Faqe 30*
5. "Vendosni sasinë shtesë të shkëlqyesit të enëve." → *Faqe 33*

Këshillë Këto cilësime dhe të tjera "cilësime bazë" → *Faqe 42* mund t'i ndryshoni sërish në çdo kohë.

Sistemi i zbutjes së ujit

Uji i rëndë që përmban gëlqere lë mbetje gëlqerore në enë dhe në kazanin e larjes dhe mund të bllokojë pjesët e pajisjes.

Për të marrë rezultate të mira të shpëlarësit, ju mund ta zbusni ujin me sistemin e zbutjes dhe kripës së veçantë. Për të shmangur dëmtimet në pajisje, uji duhet zbutur me një shkallë fortësie sipër 7 °dH.

Pamja e përgjithshme e cilësimeve të fortësisë së ujit

Këtu gjeni një pamje të përgjithshme rreth vlerave të rregullueshme të shkallës së fortësisë së ujit.

Shkallën e fortësisë së ujit ju mund ta mësoni nga ujësjellësi lokal ose ta përcaktoni me një testues të fortësisë së ujit.

| Shkalla e fortësisë së ujit °dH | Zona e fortësisë | mmol/l | Vlera e cilësuar |
|--|-------------------------|---------------|-------------------------|
| 0 - 6 | E butë | 0 - 1,1 | H:00 |
| 7 - 8 | E butë | 1,2 - 1,4 | H:01 |
| 9 - 10 | Mesatare | 1,5 - 1,8 | H:02 |
| 11 - 12 | Mesatare | 1,9 - 2,1 | H:03 |
| 13 - 16 | Mesatare | 2,2 - 2,9 | H:04 |
| 17 - 21 | E fortë | 3,0 - 3,7 | H:05 |
| 22 - 30 | E fortë | 3,8 - 5,4 | H:06 |
| 31 - 50 | E fortë | 5,5 - 8,9 | H:07 |

Shënim Vendosni pajisjen tuaj në shkallën e gjetur të fortësisë së ujit.
→ *"Vendosja e sistemit të zbutjes së ujit", Faqe 30*

Në rastin e një shkalle të fortësisë së ujit të 0 - 6 °dH ju mund të hiqni dorë nga kripa e veçantë dhe të fikni sistemin e zbutjes.

→ *"Fikja e sistemit të zbutjes", Faqe 31*

Vendosja e sistemit të zbutjes së ujit

Vendosni pajisjen në shkallën e fortësisë së ujit.

1. Përcaktoni shkallën e fortësisë së ujit dhe vlerën e duhur të vendosjes.
→ *"Pamja e përgjithshme e cilësimeve të fortësisë së ujit", Faqe 29*
2. Shtypni ①.
3. Mbani të shtypur butonin A të programit dhe shtypni Start për aq kohë, derisa ekrani të tregojë H:xx.
4. Lëshoni butonat A dhe Start të programit.
✓ Butoni A i programit pulson dhe ekrani tregon H:04.
5. Shtypni butonin C të programit, derisa të jetë vendosur shkalla e përshtatshme e fortësisë së ujit.

6. Për të ruajtur cilësimin, shtypni Start.

Kripa e veçantë

Me kripën e veçantë mund të zbusni ujin.

Mbushja e kripës speciale


Nëse treguesi për rimbushjen e kripës së veçantë ndriçon, atëherë përpara fillimit të programit mbushni drejtpërdrejt kripën e veçantë në enën rezervë për kripë të veçantë. Sasia e nevojshme për kripë të veçantë është e varur nga shkalla e fortësisë së ujit. Sa më e lartë të jetë shkalla e fortësisë së ujit, aq më lartë nevojitet sasia shtesë e kripës së veçantë.

VINI RE!

- Detergjenti mund të dëmtojë sistemin e zbutjes së ujit.
 - ▶ Mbushni enën rezervë të sistemit të zbutjes së ujit vetëm me kripë të veçantë për enëlarëse.

- Kripa e veçantë mund ta dëmtojë kazanin e larjes nëpërmjet korrozionit.
 - ▶ Në mënyrë që kripa e veçantë e derdhur të shpëlahet nga kazanin e larjes, hidhni kripën e veçantë direkt në enën rezervë përpara nisjes së programit.

1. Hapni dhe hiqni kapakun nga ena rezervë për kripën e veçantë.
2. Gjatë përdorimit të parë: Mbushni tërësisht me ujë enën rezervë.
3. **Shënim** Përdorni kripë të veçantë vetëm për makinerinë e shpëlarjes. Mos përdorni asnjë tabletë kripe. Mos përdorni kripë të veçantë. Mbushni kripën e veçantë në enën rezervë.



Hinka [a]¹

Mbushni tërësisht enën rezervë me kripë të veçantë. Uji në enën rezervë zhvendoset dhe rrjedh jashtë.

4. Vendosni dhe mbyllni kapakun në enën rezervë.

Fikja e sistemit të zbutjes

Shënim

Për të shmangur dëmtimet e pajisjes, fikni sistemin e zbutjes vetëm në rastet e mëposhtme:

- Shkalla e fortësisë së ujit është maksimumi 21 °dH dhe ju përdorni një detergjent të kombinuar me zëvendësues kripe. Detergjentet e kombinuara me lëndë zëvendësuese të kripës ju mund t'i përdorni zakonisht sipas të dhënave të prodhuesit vetëm deri në një shkallë të fortësisë së ujit nga 21 °dH pa shtimin e kripës së veçantë.
- Shkalla e fortësisë së ujit është 0 - 6 °dH. Ju mund të hiqni dorë nga kripa e veçantë.

1. Shtypni ①.
2. Mbani të shtypur butonin A të programit dhe shtypni Start për aq kohë, derisa ekrani të tregojë H:xx.
3. Lëshoni butonat A dhe Start të programit.
 - ✓ Butoni A i programit pulson dhe ekrani tregon H:04.
4. Shtypni aq herë butonin C të programit, derisa ekrani të tregojë H:00.
5. Për të ruajtur cilësimin, shtypni Start.
 - ✓ Sistemi i zbutjes është i fikur dhe treguesi i rimbushjes së kripës është i çaktivizuar.

¹ Sipas pajimit të pajisjes

Rigjenerimi i sistemit të zbutjes

Për të ruajtur funksionimin pa defekte të sistemit të zbutjes së ujit, pajisja kryen një proces rigjenerimi në intervale të rregullta kohore.

Rigjenerimi i sistemit të zbutjes së ujit bëhet në të gjitha programet përpara përfundimit të procesit të shpëlarjes kryesore. Kohëzgjatja dhe vlerat e konsumit rriten, p.sh. të ujit dhe energjisë elektrike.

Pamja e përgjithshme e vlerave të konsumit gjatë rigjenerimit të sistemit të zbutjes

Këtu gjeni një pamje të përgjithshme të kohëzgjatjes maksimale shtesë dhe vlerave të konsumit gjatë rigjenerimit dhe sistemit të zbutjes. Kolonën e vlefshme për variantin e pajisjes suaj e gjeni me anë të konsumit të ujit në programin Eco 50° nga manuali i shkurtër.

| Konsumi i ujit në litra (sipas variantit të pajisjes) | Rigjenerimi i sistemit të zbutjes pas x ciklesh shpëlarjeje | Kohëzgjatja shtesë në minuta | Konsumi shtesë i ujit në litra | Konsumi shtesë i energjisë elektrike në kWh |
|---|---|------------------------------|--------------------------------|---|
| 6,5 / 6,7 | 8 | 6 | 5 | 0,05 |
| 8,5 | 7 | 6 | 5 | 0,05 |
| 9,5 | 6 | 6 | 5 | 0,05 |
| nga 10 | 5 | 6 | 5 | 0,05 |

Vlerat e dhëna të konsumit janë vlera të matura në laborator të nxjerra sipas standardit aktual të vlefshëm dhe me anë të programit Eco 50° si dhe vlerës së vendosur nga fabrika për shkallën e fortësisë së ujit 13 - 16 °dH.

Sistemi i shkëlqyesit të enëve

Enët dhe gotat ju mund t'i lani pastër dhe pa njolla me sistemin e shkëlqyesit të enëve dhe shkëlqyesin e enëve.


Shkëlqyesi i enëve

Për të marrë rezultate optimale në tharje përdorni shkëlqyes enësh. Përdorni vetëm shkëlqyes për enëlarëse shtëpiake.


Mbushja me shkëlqyes enësh

Nëse treguesi për rimbushjen me shkëlqyes enësh ndriçon, atëherë hidhni shkëlqyes. Përdorni vetëm shkëlqyes për enëlarëse shtëpiake.

1. Shtypni ① dhe ngrini paksa ② kapakun e kutisë mbajtëse të shkëlqyesit të enëve.



2. Hidhni shkëlqyes deri te shenja max e mbushjes.



3. Kur shkëlqyesi i enëve derdhet, atëherë shpëlani kazanin e larjes. Shkëlqyesi i derdhur mund të çojë në formimin e tepruar të shumës gjatë procesit të larjes.
4. Mbyllni kapakun e kutisë mbajtëse të shkëlqyesit të enëve.
 - ✓ Kapaku mbyllet me kërcitje të dëgjueshme.

Vendosja e sasisë shtesë së shkëlqyesit

Nëse në pajisje mbeten vija ose njolla uji, atëherë ndryshoni sasinë shtesë të shkëlqyesit të enëve.

1. Shtypni ①.

2. Mbani të shtypur butonin A të programit dhe shtypni Start për aq kohë, derisa ekrani të tregojë H:xx.
3. Lëshoni butonat A dhe Start të programit.
 - ✓ Butoni A i programit pulson dhe ekrani tregon H:04.
4. Shtypni butonin A të programit aq herë, derisa ekrani të tregojë vlerën e përcaktuar nga ana e fabrikës r:04.
5. Shtypni butonin C të programit aq herë, derisa të jetë vendosur sasia e duhur shtesë e shkëlqyesit.
 - Një nivel i ulët i jep procesit të larjes më pak shkëlqyes dhe redukton vijat në enë.
 - Një nivel më i lartë i jep procesit të larjes më shumë shkëlqyes, redukton njollat e ujit dhe krijon një rezultat më të lartë në tharje.
6. Për të ruajtur cilësimin, shtypni Start.

Fikja e sistemit të shkëlqyesit të enëve

Nëse treguesi i rimbushjes me shkëlqyes ju shqetëson, p.sh. nëse përdorni detergjent të kombinuar me komponentë shkëlqyes, atëherë ju mund ta fikni sistemin e shkëlqyesit të enëve.

Këshillë Funkzioni i shkëlqyesit të enëve është i kufizuar në rastin e detergjenteve të kombinuara. Nëse ju përdorni shkëlqyes, atëherë zakonisht arrini rezultate më të mira.

1. Shtypni ①.
2. Mbani të shtypur butonin A të programit dhe shtypni Start për aq kohë, derisa ekrani të tregojë H:xx.
3. Lëshoni butonat A dhe Start të programit.
 - ✓ Butoni A i programit pulson dhe ekrani tregon H:04.

4. Shtypni butonin A të programit aq herë, derisa ekrani të tregojë vlerën e përcaktuar nga ana e fabrikës r:04.
5. Shtypni aq herë butonin C të programit, derisa ekrani të tregojë r:00.
6. Për të ruajtur cilësimin, shtypni Start.
 - ✓ Sistemi i shkëlqyesit të enëve është i fikur dhe treguesi i mbushjes me shkëlqyes është i çaktivizuar.

Detergjenti

Mësoni, se cilët detergjente janë të përshtatshëm për pajisjen tuaj.

Detergjenti i përshtatshëm

Përdorni vetëm detergjent, i cili është i përshtatshëm për enëlarësen. Të përshtatshëm janë si detergjentet Solo ashtu edhe detergjentet e kombinuar.

Për të arritur rezultate optimale të shkëlqyesit dhe të tharjes, përdorni detergjent solo në lidhje me përdorimin e ndarë të "kripës së veçantë" → *Faqe 30* dhe "shkëlqyesit" → *Faqe 32*.

Detergjentet moderne dhe efikase përdorin zakonisht një recetë me përbajtje të ulët alkali me enzima. Enzimat e shpërbëjnë nishestenë dhe i tretin albuminat. Për largimin e njollave me ngjyrë përdoren zakonisht mjetet e zbardhjes në bazë të oksigjenit, p.sh. për çaj ose keçap.

Shënim Mbani parasysh të çdo detergjent udhëzimet e prodhuesit.

| Detergjenti | Përshkrimi |
|------------------------|---|
| Tabletat | Tabletat janë të përshtatshme për të gjitha detyrat e detergjentit dhe nuk duhen të jenë të dozuara. Në rastin e programeve të shkurtuara tabletat në rastin e dhënë nuk mund të treten plotësisht dhe mund të mbeten mbetje detergjenti. Nga kjo efekti i detergjentit mund të cenohet. |
| Detergjenti pluhur | Detergjentet pluhur rekomandohen gjatë programeve të shkurtuara. Doza mund të përshtatet me shkallën e kontaminimit. |
| Detergjenti i lëngshëm | Detergjentet e lëngshëm ndikojnë më shpejt dhe rekomandohen gjatë programeve të shkurtra pa paralarje. Mund të ndodhë, që detergjenti i lëngshëm i mbushur të dalë pavarësisht dhomëzës së mbyllur të detergjentit. Kjo nuk është mangësi dhe një mënyrë jo kritike, nëse mbani parasysh si më poshtë: <ul style="list-style-type: none">■ Zgjidhni vetëm një program pa paralarje.■ Mos vendosni asnjë zgjedhje paraprake kohore për fillimin e programit. Doza mund të përshtatet me shkallën e kontaminimit. |

Këshillë Produktet e përshtatshme të pastrimit mund të blihen online nëpërmjet faqes sonë të internetit ose te "shërbimi për klientin" → *Faqe 62*.

Detergjentet Solo

Detergjentet Solo janë produkte, të cilat përveç detergjenteve nuk përmbajnë përbërës të tjerë, p.sh. detergjentet pluhur ose detergjentet e lëngshëm.

Me detergjentet pluhur dhe detergjentet e lëngshëm mund të përshtatet individualisht dozimi në shkallën e ndotjes së enës. Për të marrë një rezultat më të mirë të larjes dhe të tharjes dhe për të shmangur dëmtimet e pajisjes, përdorni për më tepër "kripë të veçantë" → *Faqe 30* dhe "shkëlqyes" → *Faqe 32*.

Detergjenti i kombinuar

Përveç detergjenteve të zakonshëm Solo ofrohen një varg produktesh me funksione shtesë. Përveç detergjentit, këto produkte përmbajnë shkëlqyes dhe lëndë për zëvendësimin e kripës (3në1), dhe në varësi nga kombinimi (4në1, 5në1, ...) përmbajnë edhe komponentë plotësues, si p.sh. agjent mbrojtës të gotave ose shkëlqyes të çelikut inox. Detergjentet e kombinuara funksionojnë sipas të dhënave të prodhuesit si rregull vetëm deri në një shkallë të fortësisë së ujit të 21 °dH. Në një shkallë të fortësisë së ujit të 21 °dH ju duhet të shtoni kripë të veçantë dhe shkëlqyes. Për rezultatet më të mira të larjes dhe të tharjes ne ju rekomandojmë që në një shkallë fortësie të ujit nga 14 °dH të përdorni kripën e veçantë dhe shkëlqyes. Nëse përdorni detergjent të kombinuar, atëherë programi i shpëlarjes përshtatet në mënyrë

automatike, për të marrë rezultatin më të mirë të mundshëm të shpëlarjes dhe tharjes.

Detergjenti i papërshtatshëm

Mos përdorni asnjë detergjent, i cili mund të shkaktojë dëmtime në pajisje ose të rrezikojë shëndetin.

| Detergjenti | Përshkrimi |
|---------------------------------|--|
| Detergjenti i lëngshëm | Detergjenti i lëngshëm mund të çojë në formimin në rritje të shumës dhe të shkaktojë dëmtime në pajisje. |
| Detergjenti me përmbajtje klori | Mbetjet e klorit në enë mund të rrezikojnë shëndetin. |

Udhëzime për detergjentet

Mbani parasysh udhëzimet për detergjentet në përdorimin e përditshëm.

- Produktet e pastrimit me identifikimin "Bio" ose "Öko" përdoren (nga arsye mjedisore) zakonisht në sasi të pakta të përbërësve aktiv ose hiqet dorë plotësisht nga përbërës të caktuar. Efekti i pastrimit mund të jetë i kufizuar.
- Vendoseni sistemin e shkëlqyesit të enëve dhe sistemin e zbutjes së ujit sipas detergjentit solo të përdorur ose sipas detergjentit të kombinuar.
- Detergjentet e kombinuara me lëndë zëvendësuese të kripës mund të përdoren sipas të dhënave të prodhuesit vetëm deri në një shkallë të përcaktuar të fortësisë së ujit, zakonisht 21 °dH, pa shtimin e kripës së veçantë. Për rezultatet më të mira të shpëlarjes dhe të tharjes ne ju rekomandojmë

sq Detergjenti


mbas një shkalle të fortësisë së ujit të 14 °dH përdorimin e kripës së veçantë.

- Për të shmangur ngjitjet, kapeni detergjentin me mbështjelljen e tretshme në ujë vetëm me duar të thata dhe mbusheni atë vetëm në një dhomëz të thatë të detergjentit.
- Edhe nëse treguesi i mbushjes me shkëlqyes dhe treguesi i mbushjes me kripë të veçantë ndriçojnë programet e larjes zhvillohen pa të meta gjatë përdorimit të detergjenteve të kombinuar.
- Funkzioni i shkëlqyesit të enëve është i kufizuar në rastin e detergjenteve të kombinuara. Nëse ju përdorni shkëlqyes, atëherë zakonisht arrini rezultate më të mira.
- Përdorni tabletat me fuqinë e veçantë të tharjes.

Mbushja e detergjentit

1. Për të hapur dhomëzën e detergjentit, shtypni mbylljen me shul.

2. Mbushni detergjentin në dhomëzën e thatë të detergjentit.




Nëse përdorni tabletat, atëherë mjafton një tabletë. Futni tërthorazi tabletat.

Nëse përdorni detergjent pluhur ose të lëngshëm, atëherë mbani parasysh udhëzimet e dozimit të prodhuesit dhe klasifikimin e dozimit të dhomëzës së detergjentit.

Në rastin e ndotjes normale mjaftojnë 20 ml – 25 ml detergjent. Në rastin e enëve pak të ndotura mjafton një sasi detergjenti disi më e ulët sesa sasia e dhënë e detergjentit.

3. Mbyllni kapakun e dhomëzës së detergjentit.



- ✓ Kapaku mbyllet me kërcitje të dëgjueshme.
- ✓ Dhomëza e detergjentit hapet automatikisht në varësi të programit në pikën kohore optimale gjatë ecurisë së programit. Detergjenti pluhur ose detergjenti lëng shpërndahet në kazanin e larjes dhe tretet. Tabletat bien në enën mbledhëse të tabletave dhe treten të dozuara. Mos vendosni asnjë send në enën mbledhëse të tabletave, në mënyrë që tableta të tretet në mënyrë të njëjtë.

Enët

Shpëlani vetëm enën, që është e përshtatshme për makinën e shpëlarjes.

Shënim Dekoret e xhamit, pjesët e aluminit dhe pjesët e argjendit mund të zbehen ose të ndërrojnë ngjyrë gjatë shpëlarjes. Llojet e ndjeshme të gotave mund të bëhen pa shkëlqim pas disa procese shpëlarjesh.

Dëmtimet e gotave dhe të enëve

Shmangni dëmtimet e gotave dhe të enëve.

| Shkaku | Këshillë |
|---|--|
| Ena e mëposhtme nuk është e përshtatshme për makinën e shpëlarjes: <ul style="list-style-type: none"> ■ Pjesë takëmësh dhe enësh prej druri ■ Gota dekori, arti komercial dhe enë antike ■ Pjesë plastike jo të qëndrueshme ndaj nxehtësisë ■ Enë prej bakri dhe zinku ■ Enë të ndotura me hi, dyllë, graso dhe bojë ■ Pjesë shumë të vogla enësh | Shpëlani vetëm enë, të cilat janë të identifikuar nga prodhuesi si të përshtatshme për makinën e shpëlarjes. |
| Qelqi dhe ena nuk është e përshtatshme për makinën e shpëlarjes. | Shpëlani vetëm qelq dhe porcelan, që janë të identifikuar nga prodhuesi si të përshtatshme për makinën e shpëlarjes. |
| Përbërja kimike e detergjentit shkakton dëmtime. | Përdorni një detergjent, i cili është i identifikuar nga prodhuesi si ruajtës i enës. |

| Shkaku | Këshillë |
|--|--|
| Produktet e forta të pastrimit me bazë alkaline kaustike ose me përbajtje të lartë acidi, në veçanti nga ato të fushës profesionale apo të fushës industriale në kombinim me alumini nuk janë të përshtatshme për enëlarëse. | Nëse përdorni produkte të forta pastrimi alkaline kaustike ose me përbajtje të lartë acidi, veçanërisht nga ato të fushës profesionale apo të fushës industriale, atëherë mos lini asnjë pjesë prej alumini në hapësirën e brendshme të larjes së pajisjes |
| Temperatura e ujit të programit është tepër e lartë. | Zgjidhni një program me temperatura të ulëta. Hiqni qelqin dhe takëmin e ngrënies nga pajisja pas përfundimit të programit. |


Sistemi i enëve

Sistemoni siç duhet enët, për të optimizuar rezultatin e shkëlqyesit dhe për të shmangur dëmtimet në enë dhe në pajisje.

Këshilla


- Nëse përdorni pajisjen, atëherë kurseni energji dhe ujë në krahasim me larjen e duarve.
- Në faqen tonë të internetit ju gjeni shembuj falas, se si mund ta mbushni në mënyrë efikase pajisjen tuaj.
- Për të kursyer energji dhe ujë, ngarkojeni pajisjen deri në numrin e dhënë të njësisë së përcaktuar të masës.
→ "Të dhëna teknike", Faqe 63

- Për të marrë rezultate më të mira të shpëlarjes dhe tharjes, vendosini pjerrët pjesët me ngritje dhe thellime, në mënyrë që uji të mund të rrjedhë.



1. Hiqni mbetjet e trasha të ushqimit nga enët.
Për të kursyer burimet, mos i shpëlani enët me ujë të rrjedhshëm.
2. Sistemoni enët dhe mbani parasysh sa më poshtë:
 - Sistemoni enët shumë të ndotura në koshin e poshtëm të enëve, p.sh. tenxheret. Për shkak të currilit spërkatës ju merrni një rezultat më të mirë të shpëlarjes.
 - Për të shmangur dëmtimet e enëve, sistemoni enët me një qëndrim të sigurt dhe të fortë ndaj animit.
 - Për të shmangur lëndimet, sistemoni takëmet e ngrënies me majën dhe anët e mprehta të drejtuara poshtë.
 - Vendosni poshtë enët e hapura, në mënyrë që të mos grumbullohet ujë në enë.
 - Mos i bllokoni krahët e spërkatjes, në mënyrë që këto të mund të rrotullohen.
 - Mos vendosni asnjë pjesë të vogël në enën mbledhëse të tabletës dhe mos e bllokoni këtë

me enë, për të mos bllokuar kapakun e dhomëzës së detergjentit.



Zbrazja e enëve

⚠ PARALAJMËRIM **Rrezik lëndimi!**

Enët e nxehta mund të shkaktojnë djegie në lëkurë. Enët e nxehta janë të ndjeshme ndaj goditjeve, mund të thyhen dhe të shkaktojnë lëndime.


- ▶ Lini enët të ftohen disi pas përfundimit të programit dhe më pas zbrazini.
1. Për të shmangur rënien e pikave të ujit në enë, zbrazini enën nga poshtë sipër.
 2. Kontrolloni kazanin e larjes dhe aksesoret për papastërti dhe pastrojini nëse nevojitet.
→ "Pastrimi dhe kujdesi", Faqe 44

Përdorimi bazë

Hapja e derës së pajisjes

1. Nëse nuk është aktivizuar siguresa për fëmijët¹, atëherë hapni derën e pajisjes.

2. Nëse është aktivizuar siguresa për fëmijët¹, atëherë shtyni djathtas siguresën për fëmijët ① dhe hapni derën e pajisjes ②.



Ndezja e pajisjes

- ▶ Shtypni ①.
Programi Eco 50° është paracaktuar.
Programi Eco 50° është një program veçanërisht për mbrojtjen e mjedisit dhe jashtëzakonisht i përshtatshëm për enë me ndotje normale. Ai është një program me eficiencën më të lartë në kombinimin e konsumit të energjisë dhe të ujit për këto lloj enësh dhe mbështet konformitetin me rregulloren e Bashkimit Evropian "Ecodesign".
Nëse nuk e përdorni pajisjen për 15 minuta, atëherë pajisja fiket automatikisht.

¹ Sipas pajimit të pajisjes

Vendosja e programit

Për të përshtatur procesin e shpëlarjes në ndotjen e enës, vendosni një program të përshtatshëm.

- ▶ Shtypni butonin e duhur të programit.
→ *"Programet", Faqe 19*
- ✓ Programi është vendosur dhe butoni i programit pulson.

Vendosja e funksionit shtesë

Për të plotësuar zgjedhjen e programit të shpëlarjes, mund të vendosni funksionet shtesë.

Shënim Funksionet e ndërrueshme shtesë varen nga programi i zgjedhur.

→ *"Programet", Faqe 19*

- ▶ Shtypni në buton funksionin e përshtatshëm shtesë.
→ *"Funksionet shtesë", Faqe 21*
- ✓ Funksioni shtesë është vendosur dhe butoni i funksionit shtesë pulson.

Vendosja e zgjedhjes së kohës

Ju mund ta shtyni nisjen e programit deri në 24 orë.

1. Shtypni +.
- ✓ Në ekran do të shfaqet "h:01".
2. Me — ose + vendosni nisjen e programit në kohën që dëshironi.
3. Shtypni Start.
- ✓ Zgjedhja e kohës është aktivizuar.

Këshillë Për të çaktivizuar zgjedhjen e kohës shtypni — ose + aq herë derisa në ekran të shfaqet "h:00".

Nisja e programit

- ▶ Shtypni Start.
- ✓ Programi ka përfunduar, nëse ekrani tregon "0:00".

Shënim

- Nëse gjatë kohës së funksionimit doni të shtoni enë, atëherë mos përdorni kutinë mbajtëse të tabletës si dorezë për koshin e sipërm të enëve. Ju mund të bini në kontakt me tabletën pjesërisht të tretshme.
- Ju mund ta ndërroni programin në vazhdim vetëm, nëse e ndërprisni programin.
→ *"Ndërprerja e programit", Faqe 40*
- Për të kursyer energji, pajisja fiket 1 minutë pas përfundimit të programit. Nëse pas përfundimit të programit hapni menjëherë derën e pajisjes, atëherë pajisja fiket pas 4 minutash.

Ndërprerja e programit

Shënim Nëse në rastin e një pajisjeje të nxehur hapni derën e pajisjes, atëherë fillimisht liheni gjysmëhapur derën e pajisjes për disa minuta dhe më pas mbylleni. Në këtë mënyrë ju shmangni, që të formohet në pajisje mbi presioni dhe të hapet papritur dera e pajisjes.

1. Shtypni ①.
- ✓ Programi ruhet dhe pajisja fiket.
2. Për të vazhduar programin, shtypni ①.

Ndërprerja e programit

Për të përfunduar një program përpara kohe ose për të ndërruar një program të nisur, ju duhet ta ndërprisni atë.

1. Hapni derën e pajisjes.

2. Shtypni Reset 3 sec. për rreth 3 sekonda.
3. Mbyllni derën e pajisjes.
- ✓ Programi ndërpritet dhe mbyllet pas rreth 1 minute.

Fikja e pajisjes

1. Mbani parasysh udhëzimet për "përdorimin e sigurt" → *Faqe 11*.
2. Shtypni ①.
3. Për të shmangur dëmtimet nga uji që del, mbyllni plotësisht rubinetin (nuk aplikohet për pajisjet me Aqua-Stop).

Këshillë Nëse gjatë kohës së procesit të shpëlarjes shtypni ①, atëherë programi në vazhdim ndërpritet. Nëse ju ndizni pajisjen, atëherë programi vazhdon automatikisht.

Rregullimet bazë

Ju mund ta përshtatni pajisjen sipas nevojave tuaja.

Pamja e përgjithshme e cilësimeve bazë

Cilësimet bazë janë të varura nga paraqitja e pajisjes suaj.

| Rregullimi bazë | Teksti i ekranit | Zgjedhja | Përshkrimi |
|-------------------------------|-------------------|-------------|--|
| Fortësia e ujit | H:04 ¹ | H:00 - H:07 | Vendosni sistemin e zbutjes në fortësinë e ujit. → "Vendosja e sistemit të zbutjes së ujit", Faqe 30 Niveli H:00 fik sistemin e zbutjes. |
| Shtimi i shkëlqyesit të enëve | r:04 ¹ | r:00 - r:06 | Vendosni sasinë e shtimit të shkëlqyesit. → "Vendosja e sasisë shtesë së shkëlqyesit", Faqe 33 Me nivelin r:00 fikni sistemin e shkëlqyesit. |
| Tharje intensive | d:00 ¹ | d:00 - d:01 | Gjatë shpëlarjes rritet temperatura dhe në këtë mënyrë arrihet një rezultat i përmirësuar i tharjes. Nga kjo mund të rritet në mënyrë të papërfillshme kohëzgjatja. Shënim Nuk është e përshtatshme për pjesë të ndjeshme enësh. Ndizni "d:01" ose fikni "d:00" tharjen intensive. |
| Uji i ngrohtë | A:00 ¹ | A:00 - A:01 | Vendosni lidhjen e ujit të ftohtë ose të ujit të ngrohtë. Vendosni pajisjen vetëm me ujë të ngrohtë, nëse uji i ngrohtë përpunohet energjitikisht në mënyrë të volitshme dhe është në dispozicion një instalim i përshtatshëm, p.sh. një panel diellor me tubacion qarkullues. Temperatura e ujit duhet të jetë minimumi 40°C dhe maksimumi 60°C. Ndizni "A:01" ose fikni "A:00" ujin e ngrohtë. |

¹ Rregullim nga fabrika (mund të ndryshojë në varësi të llojit të pajisjes)

| Rregullimi bazë | Teksti i ekranit | Zgjedhja | Përshkrimi |
|---------------------|-------------------|-------------|--|
| TimeLight | S:01 ¹ | S:00 - S:02 | Ndizni ose fikni TimeLight. Gjatë ecurisë së programit shfaqet informacioni i statusit për zgjedhjen paraprake të kohës, për programin ose për kohën e mbetur poshtë derës së pajisjes. Në rast të panelit të tërhequr përpara të bazamentit ose të montimit të lartë që përfundon rrafsh me frontin e mobileve informacioni nuk është i dukshëm. Niveli "S:00" shuan TimeLight. |
| InfoLight | l:01 ¹ | l:00 - l:01 | Ndizni ose fikni InfoLight. Gjatë ecurisë së programit shfaqet një pikë drite në pjesën e poshtme të derës së pajisjes. Në rast të montimit të lartë, rrafsh me fasadën e mobilie, pika e dritës nuk është e dukshme. Nëse pika e dritës pulson, atëherë dera e pajisjes nuk është e mbyllur plotësisht. Nëse pika e dritës nuk është më e dukshme në pjesën e poshtme, atëherë programi ka përfunduar. Niveli "l:00" shuan InfoLight. |
| Fortësia e sinjalit | b:02 ¹ | b:00 - b:03 | Rregullimi i fortësisë së sinjalit. Treguesi akustik i përfundimit të programit nga një tingull i sinjalit. Niveli "b:00" shuan tingullin e sinjalit. |

¹ Rregullim nga fabrika (mund të ndryshojë në varësi të llojit të pajisjes)

Ndryshimi i cilësimeve bazë

- Hapni derën e pajisjes.
- Shtypni ①.
- Mbani të shtypur butonin A të programit dhe shtypni Start për aq kohë, derisa ekrani të tregojë H:xx.
- Lëshoni butonat A dhe Start të programit.
- ✓ Butoni A i programit pulson dhe ekrani tregon H:04.
- Shtypni aq herë butonin A të programit, derisa ekrani të tregojë cilësimin e dëshiruar.
- Shtypni aq herë butonin C të programit, derisa ekrani të tregojë vlerën e përshtatshme. Ju mund të ndryshoni disa cilësime.
- Për të ruajtur cilësimin, shtypni Start.
- Mbyllni derën e pajisjes.

Pastrimi dhe kujdesi

Në mënyrë që pajisja të qëndrojë funksionale për kohë të gjatë, pastrojeni dhe kujdesuni për të me kujdes.

Pastrimi i kazanit të larjes

PARALAJMËRIM

Rrezik dëmsh në shëndet!

Përdorimi i detergjenteve me përbajtje klori mund të shkaktojë dëmtime të shëndetit.

► Mos përdorni kurrë detergjente me përbajtje klori.

1. Hiqni papastërtitë e ashpra në hapësirën e brendshme me një pëlthurë të lagur.
2. Mbushni detergjentin në dhomëzën e detergjentit.
3. Zgjidhni programin me temperaturën më të lartë.
→ "Programet", Faqe 19
4. "Startoni programin pa enë."
→ Faqe 40

Hapësira e brendshme e vetë pastruesit¹

Për të hequr depozitimet, pajisja kryen në periudha të rregullta kohore një vetëpastrim të hapësirës së brendshme.

Për vetëpastrimin ecuria e programit përshtatet automatikisht, p.sh. rritet në kohë të shkurtër temperatura e pastrimit. Vlerat e konsumit mund të rriten, p.sh. uji dhe energjia elektrike. Nëse hapësira e brendshme nuk pastrohet më vetë mjaftueshëm dhe krijohen depozitime, atëherë mbani

parasysh këto informacione:

→ "Pastrimi i kazanit të larjes", Faqe 44.

Produktet e pastrimit

Përdorni vetëm produkte pastrimi të përshtatshme për pastrimin e pajisjes.

→ "Përdorimi i sigurt", Faqe 11

Këshilla për kujdesin e pajisjes

Mbani parasysh këshillat për kujdesin e pajisjes, për të ruajtur vazhdimisht funksionin e pajisjes suaj.

| Marrja e masave | Avantazhi |
|---|--|
| Vulat e derës, anën e përparme të enëlarësës dhe panelin e kontrollit fshijini rregullisht me një pëlthurë të lagur dhe ilaç enësh. | Pjesët e pajisjes mbeten të pastra dhe higjienike. |
| Derën e pajisjes lëreni gjysmëhapur gjatë kohës më të gjatë të qëndrimit. | Formimi i pakëndshëm i aromës shmanget. |

Mirëmbajtja e enëlarësës ¹

Depozitimet në pajisjen tuaj mund të çojnë në defekte, p.sh. nga yndyra dhe gëlqerja. Për të shmangur defektet dhe për të reduktuar formimin e aromës, pastrojeni pajisjen tuaj në periudha të rregullta kohore.

Mirëmbajtja e enëlarësës është, për sa i përket detergjenteve të zakonshëm për mirëmbajtje, programi i duhur për mirëmbajtjen e pajisjes suaj.

¹ Sipas pajimit të pajisjes


Nëse treguesi për Mirëmbajtja e enëlarësës ndriçon në panelin e kontrollit ose ekrani këshillon për këtë, atëherë vini në veprim programin Mirëmbajtja e enëlarësës pa enë. Pasi të keni kryer programin për mirëmbajtjen e enëlarësës, treguesi fiket. Nëse pajisja juaj nuk ka funksion alarmi, atëherë ndiqni udhëzimet e përdorimit që ndodhen në detergjentet për enëlarëse.

Ekzekutimi i Mirëmbajtja e enëlarësës

Nëse treguesi për Mirëmbajtja e enëlarësës ndriçon në panelin e kontrollit ose ekrani këshillon për këtë, atëherë kryeni programin Mirëmbajtja e enëlarësës.


Shënime

- Kryeni programin Mirëmbajtja e enëlarësës pa e mbushur atë me enë.
 - Përdorni vetëm detergjent të veçantë pastrimi të përshtatshëm për enëlarëse dhe jo detergjent enësh. Mbani parasysh të dhënat e prodhuesit.
 - Kini parasysh, që të mos ketë asnjë pjesë alumini në hapësirën e shpëlarjes së pajisjes.
 - Nëse nuk keni kryer Mirëmbajtja e enëlarësës pas 3 proceseve të shpëlarjes, atëherë treguesi fiket automatikisht për Mirëmbajtja e enëlarësës.
 - Mbani parasysh udhëzimet e sigurisë dhe të përdorimit që gjenden në ambalazhin e detergjentit për mirëmbajtjen e enëlarësës.
1. Hiqni papastërtitë e ashpra në hapësirën e brendshme me një pëlthurë të lagur.
 2. Pastrojini sitat.
 3. Mbushni në pajisje detergjentin për mirëmbajtjen e enëlarësës.

4. Shtypni .
 5. Shtypni Start.
- ✓ Kryhet mirëmbajtja e enëlarësës.
 - ✓ Sapo mirëmbajtja e enëlarësës të ketë përfunduar, atëherë fiket treguesi për Mirëmbajtja e enëlarësës.

Sistemi i filtrave sitë

Sistemi i filtrave sitë filtron papastërtitë e ashpra nga cikli i shpëlarjes.



- | | |
|---|-----------------|
| 1 | Mikrosita |
| 2 | Sita e rafinuar |
| 3 | Sita e trashë |


Pastrimi i sitës

Papastërtitë nga uji i larjes mund të bllokojnë sitën.


1. Pas çdo shpëlarje kontrolloni sitën për mbeturina.

sq Pastrimi dhe kujdesi


2. Rrotulloni sitën e trashë në sensin e kundërt të akrepave të orës ① dhe hiqni sistemin e filtrave sitë ②.
 - Kini parasysh, që të mos bjerë asnjë trup i huaj në tabanin e pompës.



3. Tërhiqni poshtë mikrositën.



4. Shtypni njëkohësisht gjuhëzat e kapjes ① dhe nxirrni sipër sitën e trashë ②.



5. Pastroni me ujë të rrjedhshëm elementët e sitës.

Pastroni me kujdes anën e ndotjes ndërmjet sitës së trashë dhe sitës së rafinuar.

6. Montoni sistemin e filtrave sitë.


Mbani parasysh, që në sitën e trashë të jenë fiksuar gjuhëzat e kapjes.
7. Vendosni sistemin e filtrave sitë në pajisje dhe rrotulloni sitën e trashë në sensin e akrepave të orës.

Mbani parasysh, që shenjat e shigjetës të qëndrojnë përballë njëri-tjetrit.


Pastrimi i krahëve të spërkatjes

Gëlqerja dhe papastërtitë nga uji i larjes mund të bllokojnë vrimat dhe kushinetat e krahëve të spërkatjes. Pastroni rregullisht krahët e spërkatjes.

1. Zhvidhosni krahët e sipërme të spërkatjes ① dhe tërhiqini për poshtë ②.



2. Krahun e poshtëm të spërkatjes tërhiqeni për sipër.



3. Kontrolloni për bllokime në ujë të rrjedhshëm vrimat e daljes së krahëve të spërkatjes dhe largoni objektet e huaja nëse nevojitet.
4. Vendosni krahun e poshtëm të spërkatjes.
- ✓ Krahu i spërkatjes mbyllet me kërcitje të dëgjueshme.
5. Vendosni dhe mbërtheni fort krahët e sipërme të spërkatjes.

Mënjanimi i defekteve

Defektet e lehta në pajisje mund t'i eliminoni edhe vetë. Përdorni informacionet për eliminimin e defekteve përpara se të kontaktoni me shërbimin për klientin. Kështu shmangni shpenzimet e panevojshme.

PARALAJMËRIM

Rrezik nga goditja elektrike!

Riparimet e gabuara janë shkak për rreziqe.


- ▶ Riparimet në pajisje duhen kryer vetëm nga staf teknik i trajnuar për këtë qëllim.
- ▶ Për riparimin e pajisjes lejohet të përdoren vetëm pjesë këmbimi origjinale.
- ▶ Nëse dëmtohet kordoni elektrik i pajisjes, atëherë ai duhet të zëvendësohet me një kordon elektrik të veçantë, të cilin mund ta blini te prodhuesi ose te shërbimi i tij për klientin.

Siguria e pajisjes

| Defekti | Shkaku | Zgjidhja e problemeve |
|--|--|--|
| Dera e pajisjes nuk mund të hapet ose hapet vetëm me vështirësi. | Brava e sigurisë për fëmijët është e aktivizuar. | ▶ "Hapni derën e pajisjes." → <i>Faqe 39</i> |

Kodi i gabimit / Treguesi i gabimit / Sinjali

| Defekti | Shkaku | Zgjidhja e problemeve |
|--|---|---|
| E:07 ndriçon. | Vrima e thithjes e enës prej zeoliti është e mbuluar nga pjesë e enëve. | ▶ Vendosni pjesët e enëve në pajisje në atë mënyrë që "vrime të thithjes e enës prej zeoliti" → <i>Faqe 16</i> të jetë e lirë. |
| E:12 ndriçon. | Elementi i nxehësisë është gëlqerizuar. | <ol style="list-style-type: none"> 1. Çgëlqerizoni pajisjen. 2. Vini në punë pajisjen me sistemin e zbutjes. |
| E:14 ndriçon. | Sistemi i mbrojtjes së ujit është aktivizuar. | <ol style="list-style-type: none"> 1. Mbyllni rubinetin. 2. Telefononi "shërbimin e klientit" → <i>Faqe 62</i>. |
| E:15 ndriçon. | Sistemi i mbrojtjes së ujit është aktivizuar. | <ol style="list-style-type: none"> 1. Mbyllni rubinetin. 2. Telefononi "shërbimin e klientit" → <i>Faqe 62</i>. |
| E:16 ndriçon. | Uji rrjedh vazhdimisht në pajisje. | <ol style="list-style-type: none"> 1. Mbyllni rubinetin. 2. Telefononi "shërbimin e klientit" → <i>Faqe 62</i>. |
| E:18 ose treguesi për furnizimin me ujë ndriçon. | Tubi i furnizimit është përthyer. | ▶ Shtroni tubin e furnizimit pa përthyerje. |


| Defekti | Shkaku | Zgjidhja e problemeve |
|--|---|--|
| E:18 ose treguesi për furnizimin me ujë ndriçon. | Rubineti është i mbyllur. | ▶ Hapni rubinetin. |
| | Rubineti ka ngecur ose është gëlqerizuar. | ▶ Hapni rubinetin. Sasia e rrjedhjes gjatë furnizimit të hapur të ujit duhet të jetë minimumi 10 l/min. |
| Sita në tubin e furnizimit me ujë është bllokuar. | | 1. Fikni pajisjen. |
| | | 2. Tërhiqni spinën e rretit. |
| | | 3. Mbyllni duke rrotulluar rubinetin. |
| | | 4. Zhvidhosni lidhjen e ujit. |
| | | 5. Merrni sitën nga tubi i furnizimit me ujë |
| | | |
|  | | |
| | | 6. Pastroni sitën. |
| | | 7. Vendosni sitën në tubin e furnizimit me ujë. |
| | | 8. Vidhosni lidhjen e ujit. |
| | | 9. Kontrolloni lidhjen e ujit për rrjedhje. |
| | | 10. Vendosni furnizimin me energji elektrike. |
| | | 11. Ndizni pajisjen. |
| E:22 ndriçon. ¹ | Sitat janë të ndotura ose të bllokuara. | ▶ Pastroni sitën. → "Pastrimi i sitës", Faqe 45 |
| E:24 ndriçon. | Tubi shkarkues është i bllokuar ose i përthyer. | 1. Shtroni pa përthyerje tubin shkarkues. 2. Hiqni mbetjet. |
| | Lidhja e sifonit është ende e mbyllur. | ▶ Kontrolloni lidhjen në sifon dhe hapeni atë në rast nevojë. |
| | Kapaku i pompës së shkarkimit është i lirshëm. | ▶ Puthitni siç duhet kapakun e "pompës së shkarkimit" → Faqe 61. |

¹ Sipas pajimit të pajisjes

| Defekti | Shkaku | Zgjidhja e problemeve |
|--|---|---|
| E:25 ndriçon. | Pompa e shkarkimit është e bllokuar. | ▶ Pastroni pompën e shkarkimit. → "Pastrimi i pompës së shkarkimit", Faqe 61 |
| | Kapaku i pompës së shkarkimit është i lirshëm | ▶ Puthitni siç duhet kapakun e "pompës së shkarkimit" → Faqe 61. |
| E:27 ndriçon. | Tensioni i rrjetit është i ulët. | Nuk ekziston asnjë gabim i pajisjes. 1. Telefononi një electricist. 2. Lëreni electricistin të kontrollojë tensionin e rrjetit dhe instalimin elektrik. |
| Një tjetër kod i gabimit shfaqet në tregues. E:01 deri E:30 | Ekzistimi i një defekti teknik. | 1. Shtypni ①. 2. Tërhiqni spinën e rrjetit të pajisjes ose fikni siguresën. 3. Prisni të paktën 2 minuta. 4. Fusni spinën e rrjetit të pajisjes në një prizë ose ndizni siguresën. 5. Ndizni pajisjen. 6. Nëse problemi shfaqet sërish: – Shtypni ①. – Mbyllni rubinetin. – Tërhiqni spinën e rrjetit. – Kontaktoni me "shërbimin e klientit" → Faqe 62 dhe përmendni kodin e gabimit. |

Rezultati i shpëlarjes

| Defekti | Shkaku | Zgjidhja e problemeve |
|----------------------|--|---|
| Ena nuk është tharë. | Mospërdorimi i shpëlarësit ose dozimi është vendosur tepër ulët. | 1. Mbushni "shkëlqyesin" → Faqe 32. 2. Vendosni sasinë e shtimit të shkëlqyesit. |
| | Programi i zgjedhur nuk ka asnjë fazë të tharjes | ▶ Zgjidhni një program me tharje. |

| Defekti | Shkaku | Zgjidhja e problemeve |
|------------------------------------|--|---|
| Ena nuk është tharë. | Uji grumbullohet në thellimet e enës ose të takëmit të ngrënies. | <p>► Mundësisht sistemojini enët në mënyrë të pjerrët.</p>  |
| | Detergjenti i kombinuar që përdoret ka fuqi të dobët të tharjes. | <ol style="list-style-type: none"> 1. Përdorni shkëlqyes për të rritur fuqinë e tharjes. 2. Përdorni një pastrues tjetër të kombinuar me një fuqi më të mirë të tharjes. |
| | Tharja ekstra nuk është aktivizuar për rritjen e tharjes. | <p>► Aktivizoni tharjen ekstra.</p> |
| | Ena është pastruar tepër herët ose procesi i tharjes nuk është përfunduar ende. | <ol style="list-style-type: none"> 1. Prisni përfundimin e programit. 2. Nxirrni enën vetëm 30 minuta pas përfundimit të programit. |
| | Shkëlqyesi i përdorur ka fuqi të kufizuar në tharje. | <p>► Përdorni shkëlqyes të markave të njohura.</p> <p>Produktet ekologjike mund të kenë një fuqi të kufizuar të ndikimi.</p> |
| Ena plastike nuk është e tharë. | Nuk është gabim. Nëpërmjet një aftësie të ulët të ruajtjes së ngrëntsisë plastika thahet më dobët. | <p>► Nuk mund të jepet asnjë zgjidhje ndihmëse.</p> |
| Takëmi i ngrënies nuk është tharë. | Takëmet e ngrënies janë vendosur në mënyrë të papërshtatshme në koshin ose në sirtarin e takëmeve të ngrënies. | <ol style="list-style-type: none"> 1. Sistemoni siç duhet takëmet e ngrënies. → "Sistemimi i enëve", Faqe 38 2. Sistemoni të veçuara sipas mundësisë takëmet e ngrënies. 3. Shmangni pikat e instalimit. |

| Defekti | Shkaku | Zgjidhja e problemeve |
|---|---|---|
| Anët e brendshme të pajisjes pas procesit të shpëlarjes janë të lagura. | Nuk është gabim. Nëpërmjet tharjes së kondensimit pikat e ujit në kazanin e larjes janë fizikisht të kushtëzuara dhe të dëshiruara. Lagështia në ajër kondenson në anët e brendshme të pajisjes, rrjedh dhe thithet me pompë. | Nuk është i nevojshëm asnjë veprim. |
| Mbetje ushqimi në enë. | Enët janë të pozicionuara shumë afër. | <ol style="list-style-type: none"> 1. Sistemoni enët me hapësirë të mjaftueshme midis tyre. Rrezet e spërkatjes duhet të arrijnë sipërfaqen e enës. 2. Shmangni pikat e instalimit. |
| | Koshi i enëve është tejmbushur. | <ol style="list-style-type: none"> 1. Sistemoni enët me hapësirë të mjaftueshme midis tyre. Rrezet e spërkatjes duhet të arrijnë sipërfaqen e enës. 2. Shmangni pikat e instalimit. |
| | Rrotullimi i krahut të spërkatjes është i bllokuar. | ► Sistemoni enët në atë mënyrë që enët të mos pengojnë rrotullimin e krahut të spërkatjes. |
| | Vrimat e krahut të spërkatjes janë bllokuar. | ► Pastroni "krahët e spërkatjes" → <i>Faqe 46</i> . |
| | Sitat janë të ndotura. | ► Pastroni sitën. → <i>"Pastrimi i sitës", Faqe 45</i> |
| | Sitat janë vendosur gabim dhe/ose nuk janë të mbyllura. | <ol style="list-style-type: none"> 1. Vendosni siç duhet sitat. → <i>"Sistemi i filtrave sitë", Faqe 45</i> 2. Mbyllni sitat. |
| | Programi i shpëlarjes është zgjedhur shumë i dobët. | <ul style="list-style-type: none"> ► Zgjidhni një program më të fortë të shpëlarjes. ► Përshtatni ndjeshmërinë e sistemit të sensorëve. |
| | Enët janë para pastruar shumë fort. Sistemi i sensorëve vendos për një ecuri të dobët programi. Ndotjet rezistente nuk mund të hiqen pjesërisht. | ► Hiqni vetëm mbetjet e trasha të ushqimit dhe mos i shpëlani enët. |

| Defekti | Shkaku | Zgjidhja e problemeve |
|--|--|--|
| Mbetje ushqimi në enë. | Enë të larta dhe të holla nuk pastrohen në mënyrë të mjaftueshme në zonën e qoshes. | ▶ Mos i sistemoni shumë pjerrët enët e larta, të holla dhe jo në zonën e qoshes. |
| | Koshi i sipërm i enëve nuk është vendosur në të njëjtën lartësi djathtas dhe majtas. | ▶ Vendosni koshin e sipërm të enëve në të njëjtën lartësi majtas dhe djathtas. → <i>"Koshi i sipërm i enëve", Faqe 23</i> |
| Mbetjet e detergjentit në pajisje | Kapaku i dhomëzës së pastrimit është bllokuar nga pjesë të enëve dhe nuk hapet. | 1. Sistemoni enët në koshin e sipërm të enëve në atë mënyrë që kutia mbajtëse e tabletës të mos bllokohet nga enët. → <i>"Sistemimi i enëve", Faqe 38</i> Pjesët e enëve bllokojnë kapakun e detergjentit. 2. Mos vendosni asnjë enë dhe asnjë shpërndarës arome në enën mbledhëse të tabletës. |
| | Kapaku i dhomëzës së detergjentit është bllokuar nga tableta dhe nuk hapet. | ▶ Vendoseni tabletën tërthorazi në dhomëzën e detergjentit dhe jo anash. |
| | Tabletat përdoren në programin e shpejtë ose programin e shkurtër. Koha e tretjes së tabletës nuk arrihet. | ▶ Zgjidhni një program më të fortë ose përdorni "detergjent pluhur" → <i>Faqe 34.</i> |
| | Efekti pastrues dhe reaksioni i tretjes zvogëlohen në rast të kohës së gjatë të magazinimit ose detergjenti është me shumë kokrriza. | ▶ Ndërroni "detergjentin" → <i>Faqe 34.</i> |
| Njollat e ujit gjenden në pjesët plastike. | Formimi i pikave të ujit në sipërfaqet plastike është i pashmangshëm fizikisht. Pas tharjes duken njolla uji. | ▶ Zgjidhni programin më të fortë. ▶ Sistemoni pjerrët enët. → <i>"Sistemimi i enëve", Faqe 38</i> ▶ Përdorni shkëlqyes enësh. → <i>"Shkëlqyesi i enëve", Faqe 32</i> ▶ Vendosni më lartë sistemin e zbutjes. |

| Defekti | Shkaku | Zgjidhja e problemeve |
|--|--|--|
| Shtresat që mund të fshihen ose janë të tretshme ndodhen në hapësirën e brendshme të pajisjes ose në derë. | Lëndët përmbajtëse të detergjentit sedimentohen. Këto shtresa zakonisht nuk mund të hiqen kimikisht. | <ul style="list-style-type: none"> ▶ Ndërroni "detergjentin" → <i>Faqe 34.</i> ▶ Pastroni mekanikisht pajisjen. |
| | Shtresa e bardhë sedimentohet në hapësirën e brendshme të pajisjes. | <ol style="list-style-type: none"> 1. Vendosni siç duhet sistemin e zbutjes. Në shumicën e rasteve duhet të rrisni cilësimin. 2. Në rast nevojë ndërroni detergjentin. |
| | Ena e kripës së veçantë nuk është e mbyllur. | ▶ Mbyllni enën e kripës së veçantë. |
| Shtresat e bardha që hiqen me vështirësi gjenden në enë, hapësirën e brendshme të pajisjes ose dyer. | Lëndët përmbajtëse të detergjentit sedimentohen. Këto shtresa zakonisht nuk mund të hiqen kimikisht. | <ul style="list-style-type: none"> ▶ Ndërroni "detergjentin" → <i>Faqe 34.</i> ▶ Pastroni mekanikisht pajisjen. |
| | Intervali i fortësisë është vendosur gabim ose fortësia e ujit është mbi 50 °dH (8,9 mmol/l). | ▶ Vendosni "sistemin e zbutjes" → <i>Faqe 29</i> në fortësinë e ujit ose rimbushni kripën e veçantë. |
| | Detergjenti 3në1, detergjenti bio ose detergjenti ekologjik nuk kanë efekt të mjaftueshëm. | ▶ Vendosni "sistemin e zbutjes" → <i>Faqe 29</i> në fortësinë e ujit dhe përdorni mjete të ndara (detergjent të markës, kripë të veçantë, shkëlqyes). |
| | Detergjenti është në dozë të pamjaftueshme. | ▶ Rrisni dozimin e detergjentit ose ndërroni "detergjentin" → <i>Faqe 34.</i> |
| | Programi i shpëlarjes është zgjedhur shumë i dobët. | <ul style="list-style-type: none"> ▶ Zgjidhni një program më të fortë të shpëlarjes. ▶ Përshtatni ndjeshmërinë e sistemit të sensorëve. |
| | Mbetje çaji ose mbetje buzëkuqi në enë. | Temperatura e shpëlarjes është tepër e ulët. |
| Mbetje çaji ose mbetje buzëkuqi në enë. | Detergjenti është në dozë të pamjaftueshme ose i papërshtatshëm. | ▶ Përdorni një "detergjent" → <i>Faqe 34</i> të përshtatshëm dhe dozojeni atë sipas udhëzimeve të prodhuesit. |
| | Enët janë para pastruar shumë fort. Sistemi i sensorëve vendos për një | ▶ Hiqni vetëm mbetjet e trasha të ushqimit dhe mos i shpëlani enët. |

| Defekti | Shkaku | Zgjidhja e problemeve |
|---|---|---|
| Mbetje çaji ose mbetje buzëkuqi në enë. | ecuri të dobët programi. Ndotjet rezistente nuk mund të hiqen pjesërisht. | |
| Shtresa me ngjyrë (blu, e verdhë, kafe) që me zor hiqen ose nuk hiqen fare gjenden në hapësirën e brendshme të pajisjes ose në enë me çelik inoksi. | Formimi i shtresës krijohet nga përbërësit e perimeve (lakra, selino, patate, makarona, ...) ose uji i çezmës (mangan). | ▶ Pastroni pajisjen. Ju mund t'i hiqni shtresat me një "pastrim mekanik" → <i>Faqe 44</i> ose me një detergjent të pajisjes. Shtresat nuk janë gjithmonë plotësisht të largueshme, por të pa dëmshme për shëndetin. |
| | Formimi i shtresës krijohet nga pjesë përbërëse metalike në enë të argjendtë ose enë alumini. | ▶ Pastroni pajisjen. Ju mund t'i hiqni shtresat me një "pastrim mekanik" → <i>Faqe 44</i> ose me një detergjent të pajisjes. Shtresat nuk janë gjithmonë plotësisht të largueshme, por të pa dëmshme për shëndetin. |
| Depozitimet me ngjyrë (të verdhë, portokalli, kafe) që hiqen lehtë gjenden në hapësirën e brendshme të pajisjes (kryesisht në zonën e dyshemesë). | Formimi i shtresës krijohet nga substanca përbërëse të mbetjeve të ushqimit dhe uji i çezmës (gëlqere), "të ngjashme me sapunin". | <ol style="list-style-type: none"> 1. Kontrolloni cilësimin e sistemit të zbutjes. → "<i>Vendosja e sistemit të zbutjes së ujit</i>", <i>Faqe 30</i> 2. Mbushni kripë të veçantë. → "<i>Mbushja e kripës speciale</i>", <i>Faqe 30</i> 3. Nëse përdorni detergjent të kombinuar (tableta), atëherë aktivizoni sistemin e zbutjes. Mbani parasysht udhëzimet për detergjentet. → "<i>Udhëzime për detergjentet</i>", <i>Faqe 35</i> |
| Pjesët plastike në hapësirën e brendshme të pajisjes janë të çngjyrosura. | Pjesët plastike në hapësirën e brendshme mund të çngjyrosen gjatë kohës së shfrytëzimit të enëlarësës. | ▶ Çngjyrosjet mund të shfaqen dhe nuk e cenojnë funksionin e pajisjes. |
| Pjesët plastike janë të çngjyrosura. | Temperatura e shpëlarjes është tepër e ulët. | ▶ Zgjidhni një program me temperaturë më të lartë të shpëlarjes. |
| | Enët janë para pastruar shumë fort. Sistemi i sensorëve vendos për një | ▶ Hiqni vetëm mbetjet e trasha të ushqimit dhe mos i shpëlani enët. |

| Defekti | Shkaku | Zgjidhja e problemeve |
|--|---|--|
| Pjesët plastike janë të çngjyrosura. | ecuri të dobët programi. Ndotjet rezistente nuk mund të hiqen pjesërisht. | |
| Njollat që mund të hiqen gjenden në gota, gota me pamje metalike dhe takëme të ngrënies. | Sasia e shtimit të shkëlqyesit është vendosur tepër lart. Asnjë shkëlqyes nuk është mbushur. | <ul style="list-style-type: none"> ▶ Vendosni sistemin e shkëlqyesit në një nivel më të ulët. ▶ → <i>"Mbushja me shkëlqyes enësh"</i>, Faqe 32 |
| | Mbetjet e detergjentit ekzistojnë në fazën e programit të shpëlarjes. Kapaku i dhomëzës së detergjentit është bllokuar nga pjesët e enëve dhe nuk hapet plotësisht. | <ul style="list-style-type: none"> 1. Sistemoni enët në koshin e sipërm të enëve në atë mënyrë që kutia mbajtëse e tabletës të mos bllokohet nga enët. → <i>"Sistemimi i enëve"</i>, Faqe 38 Pjesët e enëve bllokojnë kapakun e detergjentit. 2. Mos vendosni asnjë enë dhe asnjë shpërndarës arome në enën mbledhëse të tabletës. |
| | Enët janë para pastruar shumë fort. Sistemi i sensorëve vendos për një ecuri të dobët programi. Ndotjet rezistente nuk mund të hiqen pjesërisht. | <ul style="list-style-type: none"> ▶ Hiqni vetëm mbetjet e trasha të ushqimit dhe mos i shpëlani enët. ▶ Përshtatni ndjeshmërinë e sistemit të sensorëve. |
| Paqartësia e pakthyeshme e gotave. | Gotat nuk janë të sigurta në enëlarëse, vetëm të përshtatshme për enëlarësen. | <ul style="list-style-type: none"> ▶ Përdorni gota të sigurta në enëlarëse. ▶ Shmangni një fazë të gjatë të avullit (koha e qëndrimit) pas përfundimit të procesit të shpëlarjes. ▶ Përdorni një program me temperaturë të ulët. ▶ Vendosni sistemin e zbutjes në shkallën e fortësisë së ujit. ▶ Përdorni një detergjent me komponentë për mbrojtjen e qelqit. |
| Gjurmët e ndryshkut në takëmin e ngrënies. | Takëmi i ngrënies nuk është mjaft i qëndrueshëm ndaj ndryshkut. Tehet e thikave shpeshherë janë prekur më shumë. | <ul style="list-style-type: none"> ▶ Përdorni enë të qëndrueshme ndaj ndryshkut. |

| Defekti | Shkaku | Zgjidhja e problemeve |
|---|---|--|
| Gjurmët e ndryshkut në takëmin e ngrënies. | Takëmi i ngrënies ndryshket edhe, nëse pjesët e ndryshkura shpëlahen. | ▶ Mos shpëlani pjesë të ndryshkshme. |
| | Përmbytja e kripës në ujin e larjes është tepër e lartë. | <ol style="list-style-type: none"> 1. Largoni nga kazani i larjes kripën e veçantë të derdhur. 2. Mbylleni fort kapakun e enës së kripës së veçantë. |
| Mbetjet e detergjentit gjenden në dhomëzën e detergjentit ose në enën mbledhëse të tabletave. | Krahët e spërkatjes janë bllokuar nga pjesët e enëve dhe detergjenti nuk i shpëlan. | ▶ Sigurohuni, që krahët e spërkatjes të mos jenë të bllokuara dhe të rrotullohen lirshëm. |
| | Dhomëza e detergjentit gjatë mbushjes së detergjentit ishte e lagur. | ▶ Mbushni detergjentin vetëm në një dhomëz të thatë të detergjentit. |
| Ekzistenca e formimit të shumës së pazakontë. | Detergjenti për larje me dorë gjendet në kutinë mbajtëse të shkëlqyesit. | ▶ Hidhni menjëherë shkëlqyes enësh në kutinë mbajtëse të tij. → "Mbushja me shkëlqyes enësh", Faqe 32 |
| | Shkëlqyesi është derdhur. | ▶ Fshini shkëlqyesin me një leckë. |
| | Detergjenti i përdorur ose mbrojtësi i pajisjes formon shumë shkumë. | ▶ Ndërroni markën e detergjentit. |

Udhëzime në fushën e treguesit

| Defekti | Shkaku | Zgjidhja e problemeve |
|---|---|---|
| Treguesi i rimbushjes ndriçon për kripën e veçantë. | Kripa e veçantë mungon. | ▶ Mbushni "kripën e veçantë" → Faqe 30. |
| | Sensori nuk i njeht tabletat e kripës së veçantë. | ▶ Mos përdorni asnjë tabletë të kripës së veçantë. |
| Treguesi i rimbushjes nuk ndriçon për kripë të veçantë. | Sistemi i zbutjes është fikur. | ▶ "Vendosja e sistemit të zbutjes së ujit" → Faqe 30 |
| Treguesi i mbushjes me shkëlqyes ndriçon. | Shkëlqyesi i enëve mungon. | <ol style="list-style-type: none"> 1. Mbushni "shkëlqyesin" → Faqe 32. 2. Vendosni sasinë e shtimit të shkëlqyesit. |
| Treguesi i mbushjes me shkëlqyes nuk ndriçon. | Sistemi i shpëlarjes është fikur. | ▶ → "Vendosja e sasisë shtesë së shkëlqyesit", Faqe 33 |

| Defekti | Shkaku | Zgjidhja e problemeve |
|---|---|---|
| Ekrani pulson. | Dera e pajisjes nuk është e mbyllur plotësisht. | <ul style="list-style-type: none"> ▶ Mbyllni derën e pajisjes. <ul style="list-style-type: none"> – Sistemoni enët në mënyrë të tillë që asnjë pjesë e enëve të mos dalë sipër koshit dhe të pengojë mbylljen e sigurt të derës së pajisjes. |
| Treguesi për mirëmbajtjen e enëlarëses ndriçon. | Këshillohet kryerja e procesit të mirëmbajtjes. | <ul style="list-style-type: none"> ▶ Kryeni programin e mirëmbajtjes së enëlarëses pa enë. <ul style="list-style-type: none"> – Përdorni një produkt të veçantë për mirëmbajtjen e enëlarëses. <p>Treguesi shuhet automatikisht pas 3 proceseve të shpëlarjes, pa kryer mirëmbajtjen e enëlarëses.</p> |

Defektet e funksionit

| Defekti | Shkaku | Zgjidhja e problemeve |
|---|---|---|
| Uji mbetet në pajisje pas përfundimit të programit. | Sistemi i sitave ose zona poshtë sitave është i / e bllokuar. | <ol style="list-style-type: none"> 1. Pastroni "sitën" → <i>Faqe 45</i>. 2. Pastroni "pompën e shkarkimit" → <i>Faqe 61</i>. |
| | Programi nuk ka përfunduar ende. | <ul style="list-style-type: none"> ▶ Prisni përfundimin e programit ose ndërprisni programin me Reset. ▶ → "<i>Ndërprerja e programit</i>", <i>Faqe 40</i> |
| Pajisja nuk ndizet ose nuk mund të përdoret. | Funksionet e pajisjes kanë dështuar. | <ol style="list-style-type: none"> 1. Tërhiqni spinën e rrjetit ose fikni siguresën. 2. Prisni të paktën 2 minuta. 3. Lidhni pajisjen në rrjetin e energjisë elektrike. 4. Ndizni pajisjen. |
| Pajisja nuk starton. | Siguresa në shtëpi nuk është në rregull. | ▶ Kontrolloni siguresën në shtëpi. |
| | Kabloja e rrjetit nuk është futur. | <ol style="list-style-type: none"> 1. Kontrolloni, nëse funksionon priza. 2. Kontrolloni, nëse kabloja e rrjetit është futur plotësisht në prizë dhe në anën e pasme të pajisjes. |
| | Dera e pajisjes nuk është e mbyllur plotësisht. | ▶ Mbyllni derën e pajisjes. |
| Programi starton automatikisht. | Përfundimi i programit nuk u prit. | ▶ → " <i>Ndërprerja e programit</i> ", <i>Faqe 40</i> |

| Defekti | Shkaku | Zgjidhja e problemeve |
|--|--|--|
| Pajisja qëndron në program ose ndalet. | Dera e pajisjes nuk është e mbyllur plotësisht. | ► Mbyllni derën e pajisjes. |
| | Furnizimi me energji elektrike dhe/ose furnizimi me ujë është ndërprerë. | 1. Kontrolloni furnizimin me energji elektrike. 2. Kontrolloni furnizimin me ujë. |
| | Shporta e sipërme shtyn kundër derës së brendshme dhe parandalon një mbyllje të sigurt të derës së pajisjes. | ► Kontrolloni, nëse ana e pasme e pajisjes shtypet nga priza ose mbajtësi jo i çmontuar i tubit. ► Sistemoni enët në mënyrë të tillë që asnjë pjesë e enëve të mos dalë sipër koshit dhe të pengojë mbylljen e sigurt të derës së pajisjes. |

Dëmtimi mekanik

| Defekti | Shkaku | Zgjidhja e problemeve |
|--|--|--|
| Dera e pajisjes nuk mund të mbyllet. | Kyçi i derës ka lëvizur nga vendi. | ► Mbylleni derën me më shumë përpjekje. |
| | Mbyllja e derës është bllokuar me kushtëzim nga instalimi. | ► Kontrolloni, nëse pajisja është montuar siç duhet. Dera e pajisjes, dekori i derës ose pjesët shtesë nuk duhet të shtyhen gjatë mbylljes në dollapët pranë dhe tryezën e punës. |
| Kapaku i dhomëzës së detergjentit për pastrim nuk mbyllet. | Dhomëza e pastrimit ose kapaku janë bllokuar nga mbetjet e ngjitura të detergjentit. | ► Hiqni mbetjet e detergjentit. |

Zhurma

| Defekti | Shkaku | Zgjidhja e problemeve |
|--|---|--|
| Dëgjohet goditje nga rubineti për mbushje. | Në varësi të instalimit të shtëpisë. Mosekzistenca e gabimit të pajisjes. Mosndikimi në funksion të pajisjes. | ► Zgjidhja e mundshme vetëm në instalimin e shtëpisë. |
| Zhurme goditëse ose rrapëlluese. | Krahu i spërkatjes godet enët. | ► Sistemoni enët në atë mënyrë që krahët e spërkatjes të mos përplasen tek enët. |

sq Mënjanimi i defekteve

| Defekti | Shkaku | Zgjidhja e problemeve |
|----------------------------------|---|---|
| Zhurmë goditëse ose rrapëlluese. | Rrymat e ujit përplasen direkt në kazanin e larjes gjatë ngarkesës së ulët. | <ul style="list-style-type: none">▶ Shpërndani enët në mënyrë të barabartë.▶ Ngarkoni më shumë enë në pajisje. |
| | Enë të lehta lëvizten gjatë shpëlarjes. | <ul style="list-style-type: none">▶ Sistemoni enët e lehta në mënyrë të qëndrueshme. |

Pastrimi i pompës së shkarkimit


Mbetjet e trasha të ushqimit ose trupat e huaj mund të bllokojnë pompën e shkarkimit. Sapo uji i larjes të mos shkarkohet më siç duhet, ju duhet të pastroni pompën e shkarkimit.

⚠ PARALAJMËRIM **Rrezik lëndimi!**

Sendet e mprehta dhe me majë si ciflat e xhamit mund të bllokojnë pompën e shkarkimit dhe të shkaktojnë lëndime.


► Hiqni me kujdes trupat e huaj.

1. Ndani pajisjen nga rrjeti i energjisë elektrike.
2. Hiqni koshin e sipërm dhe të poshtëm të enëve.
3. Hiqni sistemin e sitës.
4. Zbrazni ujin ekzistues.
Përdorni si ndihmë një sfungjer nëse nevojitet.
5. Hiqni kapakun e pompës me ndihmë të një luge dhe kapeni në urë.



6. Ngrini paksa dhe hiqni kapakun e pompës pjerrët për në brendësi.
7. Hiqni mbetjet e ushqimit dhe trupat e huaj në zonën e helikës.

8. Vendosni kapakun e pompës ① dhe shtyheni për poshtë ②.



- ✓ Kapaku i pompës mbyllet me kërcitje të dëgjueshme.
9. Instalimi i sistemit të sitës.
 10. Vendosni në vend koshin e sipërm dhe të poshtëm të enëve.

Transporti, ruajtja dhe hedhja

Mësoni këtu sesi të përgatitni pajisje për transportimin dhe vendosjen në ruajtje. Gjithashtu mësoni edhe mënyrën e hedhjes së pajisjeve të vjetra.

Çmontimi i pajisjes

1. Ndani pajisjen nga rrjeti i energjisë elektrike.
2. Mbyllni rubinetin.
3. Lironi lidhjen e tubit shkarkues të ujit.
4. Shkëputni lidhjen e ujit të pijshëm.
5. Nëse ekziston, shkëputni vidat e fiksimit në pjesët e mobilies.
6. Nëse ekziston, çmontoni dërrasën e bazamentit.
7. Nxirrni me kujdes pajisjen dhe tërhiqni tubin.

Mbrojtja e pajisjes nga ngrica

Nëse pajisja ndodhet në një dhomë të rrezikuar nga ngrica, p.sh. në një shtëpi pushimi, atëherë zbrazi plotësisht pajisjen.

► "Zbrazi pajisjen." → *Faqe 62*

Transportimi i pajisjes

Për të shmangur dëmtimet e pajisjes, zbrazi pajisjen përpara transportit.

Shënim Në mënyrë që uji i mbetur të mos arrijë në komandimin e pajisjes dhe të shkaktojë dëmtime në pajisje, transportoni pajisjen vetëm në këmbë.

1. Hiqni enët nga pajisja.
2. Sigurooni pjesët e lirshme.
3. Hapni rubinetin.
4. "Ndizni pajisjen." → *Faqe 39*
5. Zgjidhni programin me temperaturën më të lartë.
→ "*Programet*", *Faqe 19*
6. "Nisni programin." → *Faqe 40*
7. Për të zbrazur pajisjen, ndërprisni programin pas rreth 4 minutash.
→ "*Ndërprerja e programit*", *Faqe 40*
8. "Fikni pajisjen." → *Faqe 41*
9. Mbyllni rubinetin.
10. Për të zbrazur ujin e mbetur nga pajisja, shkëputni tubin e furnizimit dhe lëreni ujin të rrjedhë.

Hedhja e pajisjes së vjetër

Me hedhjen e pajisjeve në mënyrë të përshtatshme për mjedisin mund të rifitohen lëndë të para të vlefshme.

PARALAJMËRIM

Rrezik dëmsh në shëndet!

Fëmijët mund të bllokohen brenda në pajisje dhe të rrezikojnë jetën.

► Në pajisjet që nuk janë në gjendje pune, hiqni spinën e kordonit elektrik, më pas pritni komplet kordonin elektrik dhe dëmtoni bravën e derës së pajisjes deri në atë pikë sa të mos mbyllet më.

1. Shkëputni spinën e kordonit elektrik.
2. Pritni kordonin elektrik.
3. Hidhni pajisjen në mënyrë të përshtatshme për mjedisin.



Ky aparat përmban shënjën e aparaturave elektrike dhe elektroteknike sipas Udhëzimit 2012/19/EU (waste electrical and electronic equipment - WEEE).

Udhëzimi jep kuadrin ligjor për të drejtën e kthimit mbrapsht të aparaturave të përdorura në të gjithë BE.

Shërbimi i klientit

Nëse keni pyetje, nëse nuk mund ta eliminoni vetë një defekt në pajisje ose nëse pajisja duhet riparuar, drejtohuni te shërbimi ynë për klientin.

Shumë probleme mund t'i mënjanoni vetë nga informacioni për eliminimin e defekteve në këtë manual ose në faqen tonë të internetit. Nëse nuk është ky rasti, atëherë drejtohuni te shërbimi ynë për klientin.

Ne garantojmë që pajisja juaj riparohet me pjesë këmbimi origjinale nga stafi i trajnuar i shërbimit për klientit në rastin e garancisë dhe pas skadimit të garancisë së prodhuesit. Pjesët origjinale të këmbimit të rëndësishme për funksionimin, në përputhje me rregulloren përkatëse të dizajnit ekologjik, i gjeni te shërbimi ynë për klientin për një periudhë të paktën 10 vjet pas vënies në qarkullim të pajisjes suaj brenda Zonës Ekonomike Evropiane.

Shënim Përdorimi i shërbimit të klientit është falas në kuadrin e kushteve të garancisë së prodhuesit.

Informacionet e detajuara rreth periudhës së garancisë dhe kushteve të garancisë në vendin tuaj i gjeni te shërbimi ynë i klientit, shitësi juaj ose në faqen tonë të internetit.

Nëse kontaktoni shërbimin e klientit, ju nevojitet numri i produktit (E-Nr.) dhe numri i prodhimit (FD) i pajisjes suaj.

Të dhënat e kontaktit të shërbimit për klientin i gjeni në listën bashkëlidhur të pikave të shërbimit për klientin ose në faqen tonë të internetit.

Numri i produktit (E-Nr.) dhe numri i prodhimit (FD)

Numrin e produktit (E-Nr.) dhe numrin e prodhimit (FD) e gjeni në tabelën e modelit të pajisjes.

Etiketën me parametrat e tipit e gjeni në anën e brendshme të derës së pajisjes.

Ju mund t'i mbani shënim këto të dhëna, për t'i gjetur shpejt përsëri të dhënat e pajisjes dhe numrin e telefonit të kujdesit për klientin.

Garancia AQUA-STOP¹

Përveç kërkesave të garancisë ndaj shitësit nga kontrata e blerjes dhe përveç garancisë sonë të prodhuesit, ne ofrojmë kompensim me kushtet e mëposhtme.

- Nëse për shkak të një defekti të sistemit tonë Aqua-Stop shkaktohet një dëm nga uji, atëherë ne u kompensojmë dëmet konsumatorëve privatë. Për të garantuar sigurimin e ujit, pajisja duhet të jetë e lidhur në rrjetin e energjisë elektrike.
- Garancia e përgjegjësive vlen për kohën e shfrytëzimit të pajisjes.
- Kushti paraprak për kërkimin e garancisë është, që pajisja të jetë instaluar dhe lidhur në mënyrë profesionale me Aqua-Stop sipas udhëzimit tonë; kjo përfshin edhe zgjatuesin e montuar profesional të Aqua-Stop (aksesor origjinal). Garancia jonë nuk përfshin linjat ose pajisjet me defekt deri në lidhjen me Aqua-Stop në rubinet.
- Në parim nuk ka nevojë që të mbikëqyrni pajisjet me Aqua-Stop gjatë punës apo që t'i siguronin ato pas pune duke mbyllur rubinetin e ujit. Rubineti i ujit duhet të mbyllet vetëm në rast të një mungese të gjatë në banesën tuaj, p.sh. gjatë pushimeve disa javore.

Të dhëna teknike

Shifrat dhe të dhënat për pajisjen tuaj i gjeni këtu.

| | |
|-----------------|---------------------------------|
| Pesha | Maks.: 45 kg |
| Tensioni | 220 - 240 V, 50 Hz ose 60 Hz |
| Vlera e lidhjes | 2000 - 2400 W |

¹ Sipas pajimit të pajisjes

| | |
|--------------------|---|
| Siguresa | 10 - 16 A |
| Fuqia | Në gjendje të fikur/në gjendje gatishmërie: 0,10 W Në gjendje jo të fikur: 0,10 W Në modalitetin e gatishmërisë e lidhur në rrjet: - W Kohëzgjatja e gjendjes jo të fikur: 0 min Kohëzgjatja, pas së cilës pajisja kalon në modalitetin e gatishmërisë e lidhur në rrjet: - min Është në përputhje me rregulloret aktuale (BE) për etiketën e konsumit të energjisë dhe ato për "Ekodesign", në momentin e vendosjes në treg. Funksionet shtesë dhe cilësimet mund të rritin konsumin e energjisë dhe të dhënat e kohëzgjatjes. |
| Presioni i ujit | <ul style="list-style-type: none"> ■ Minimumi 0,05 MPa (0,5 bar) ■ Maksimumi 1 MPa (10 bar) |
| Sasia e furnizimit | Minimumi 10 l/min |
| Temperatura e ujit | Ujë i ftohtë. Ujë i ngrohtë maksimumi: 60 °C |
| Kapaciteti | 9 - 10 njësi të përcaktuara të masës |

Ky produkt përmban burime drite me efikasitet energjiek të klasës G. Burimet e dritës ofrohen si pjesë këmbimi dhe mund të ndërrohen nga personeli i trajnuar.¹ Informacione të tjera për modelin tuaj gjeni në internet në adresën <https://energylabel.bsh-group.com>². Kjo adresë interneti lidhet me databazën zyrtare të produkteve në BE, EPREL, adresa e internetit e së cilës nuk ishte publikuar në momentin e printimit. Ndiqni udhëzimet për kërkimin e modelit. Identifikuesi i modelit jepet nga germa përpara vizës së numrit të produktit (E-Nr.) në etiketën e parametrave të tipit. Si alternativë, numrin e modelit e gjeni edhe në rreshtin e parë të etiketës së efikasitetit të energjisë BE.

¹ Sipas pajimit të pajisjes

² Vlen vetëm për vendet në Zonën Ekonomike Evropiane



A series of 24 horizontal lines for writing, starting from the top line and extending downwards to the bottom of the page.



Lined writing area consisting of horizontal lines for text entry.



Thank you for buying a Bosch Home Appliance!

Register your new device on MyBosch now and profit directly from:

- **Expert tips & tricks for your appliance**
- **Warranty extension options**
- **Discounts for accessories & spare-parts**
- **Digital manual and all appliance data at hand**
- **Easy access to Bosch Home Appliances Service**

Free and easy registration – also on mobile phones:

www.bosch-home.com/welcome



Looking for help? You'll find it here.

Expert advice for your Bosch home appliances, help with problems or a repair from Bosch experts.

Find out everything about the many ways Bosch can support you:

www.bosch-home.com/service

Contact data of all countries are listed in the attached service directory.

Robert Bosch Hausgeräte GmbH

Carl-Wery-Straße 34

81739 München

GERMANY

www.bosch-home.com



9001496342 (000930) 440 MV

sq